

E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2002

Në këtë numër:

Opinione për Politikat Ligjore

- Zgjidhja e problemit të ish-pronarëve të tokës bujqësore dhe zhvillimi i tregut të tokës në Shqipëri.
- Legjislacioni për pronat: vështrim historik dhe analizë ligjore.
- E drejta e pronës sipas K.E.D.NJ.

6

Botimi i Qendres Studimore
Mbi Praktikën Parlamentare
Dhe Demokratike

PERMBAJTJA E REVISTES:

Numri VI, viti 2002

Faqe

| | |
|---|----|
| Opinione mbi politikat ligjore: | 3 |
| Ndikimi negativ i moszgjidhjes së problemit të ish-pronarëve të tokës bujqësore në zhvillimin e tregut të tokës në Shqipëri Haxhi ALIKO | 5 |
| Procesi i kthimit të pronave pronareve të ligjshëm, domosdoshmëri për zhvillimin e shoqërisë shqiptare Grupi i ekspertëve Shërbimit Ligjor Falas (TLAS), CAFOD - Shqipëri | 13 |
| Ndryshimet kushtetuese në vendet ish-socialiste pas vitit 1989 Dr. Xhezair ZAGANJORI | 20 |
| E drejta e pronës në dritën e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut Dajena POLLO (KUMBARO) | 31 |
| <hr/> | |
| Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend Filip LAKO | 46 |
| <hr/> | |
| Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombëtare, Një këndvështrim në zhvillimet e fundit drejt marrëveshjes së asociim-stabilizimit. Detyrat apo punët e shtëpisë? Leon SHESTANI | 55 |
| <hr/> | |
| Përmbledhje e përkthyer në anglisht: Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend | 59 |

TABLE OF CONTENTS:

6th Issue, year 2002

| | Page |
|---|------|
| Opinions about Legal Policies: | 3 |
| Negative Effect on the Solution of problems of agricultural land's former landlords in the development of the land trade in Albania Prof. Haxhi Aliko | 5 |
| The process of restitution of the propriety to the legal owners, necessity for the development of the Albanian society Group of experts from the TLAS Cafod- Albania | 13 |
| Constitutional Changes in the former socialist countries after 1989 Dr. Xhezair Zaganjori | 20 |
| The right of propriety in the light of the decisions of European Court of Human Rights Dajena Pollo (Kumbaro) | 31 |
| Information on Laws Passed by Assembly Filip LAKO | 46 |
| Information on International Assemblies' Activities, A viewpoint on the last developments towards the Stabilisation and Association agreement. Task or homeworks? Leon SHESTANI | 55 |
| Summary in English : Information about Laws passed by the Assembly | 59 |

Kjo rubrikë synon paraqitjen e politikave ligjore, në mënyrë të paanshme dhe objektive. Publiku dhe subjektet e interesuara duhet të jenë të qartë për debatin politik, qëndrimet e forcave të ndryshme politike për çështje të rëndësishme që prekin interesa të një kategorie të gjerë njerëzish dhe dhe rregullimet legjislativë. Publiku është njëkohësisht dhe zgjedhësi, në këtë kontekst, ai duhet të ndërgjegjësohet për qëndrimet dhe pikëpamjet e forcave të ndryshme politike. Në këtë numër të Revistës trajtohet problemi i pronës si një çështje ligjore e rëndësishme, në kuadrin e reformave në vendin tonë dhe me interes të veçantë për publikun e gjerë.

Ndikimi negativ i moszgjidhjes së problemit të ish-pronarëve të tokës bujqësore në zhvillimin e tregut të tokës në Shqipëri

*Prof. Haxhi Aliko
Forumi Kombëtar i Tokës-Tiranë*

Në tërësinë e reformave dhe strategjive të përpunuara për të realizuar transformimet që duheshin kryer gjatë tranzicionit në sektorin e bujqësisë, vendin qendror e përbënin proceset që lidheshin me krijimin e tregjeve dhe institucioneve përkatëse që mungonin plotësisht. Krijimi i tregut të tokës përbën ndoshta përpjekjen më të rëndësishme e më të vështirë, sepse për arritjen e tij duhej krijuar gjithçka nga e para në të gjithë përbërësit që lipsen për funksionimin e tregut: ekzistenca e mallit (toka bujqësore pronë private), krijimi i institucioneve dhe infrastrukturës së nevojshme për transaksionet, krijimi i legjislacionit dhe procedurave të domosdoshme, si dhe krijimi i psikologjisë së re të tregut të tokës.

Megjithëse gjatë këtyre 10 vjetëve të tranzicionit ka arritje të rëndësishme, na duhet të pohojmë se zgjidhja përfundimtare e problemit nuk duket të jetë shumë e afërt. Mjaft probleme kanë lindur dhe ato ndikojnë dukshëm negativisht jo vetëm në krijimin dhe funksionimin e tregut të tokës, por edhe në tejzgjatjen e tranzicionit të Shqipërisë dhe të integritimit të ardhshëm të saj në institucionet ekonomike dhe politike rajonale dhe ndërkombëtare.

Ndërmjet problemeve të pazgjidhura që kanë ndikim negativ në

zhvillimin e tregut të tokës bujqësore në Shqipëri, ai i ish-pronarëve të tokës bujqësore përbën ndoshta më të vështirin dhe më të rëndësishmin për t'u zgjidhur. Trajtimi i lindjes së problemit, i përpykëve të derisotme për zgjidhjen e tij, i ndikimit negativ të tij në zhvillimin e tregut të tokës dhe i problemeve për zgjidhjen përfundimtare të tij, përbëjnë qëllimin e këtij materiali.

Tregu i tokës kërkon detyrimisht ekzistencën e pronësisë private mbi tokën bujqësore. Por në Shqipëri, deri në përmbysjen e diktaturës, nuk ekzistonte prona private, prandaj hapi i parë i procesit të transformimit për në ekonominë e lirë të tregut ishte patjetër privatizimi i tokës. Ky hap u bë nga Kuvendi i Shqipërisë në korrik të vitit 1991 kur u miratua ligji “Për tokën”. Ky ligj ishte një ligj reforme, por njëherazi edhe ligj pronësie, sepse prekte jo vetëm shpërndarjen e tokës bujqësore, por edhe të drejtën mbi pronësinë.

Sipas ligjit nr.7501 “Për tokën” nuk përfitonin të rimerrnin pronën familjet që ishin shpronësuar nga Reforma Agrare, por toka u shpërndahej familjeve që jetonin në fshat deri më 31 korrik 1991 dhe u jepej “... në pronësi ose përdorim personave juridikë ose fizikë pa kompensim” (neni 3). Kjo tokë “nuk mund të shitej ose të blihej” (neni 2). Madhësia dhe vendndodhja e tokës që do të jepej në pronësi do të përcaktoheshin nga një komision i veçantë (Komisioni i Tokës) (neni 5), i cili do të përcaktonte kriteret e ndarjes dhe të shpërndarjes së tokës, si dhe do të përpunonte procedurat përkatëse që përmblihdeshin në një sërë vendimesh të Qeverisë.

Procesi i zbatimit të ligjit “Për tokën” nisi shumë shpejt dhe ritmet e privatizimit të tokës ishin me të vërtetë spektakolare. Vetëm brenda katër muajve të parë (shtator-dhjetor 1991) u privatizuan mbi 50% të tokës bujqësore.

Megjithëse zbatimi i ligjit “Për tokën” realizoi me sukses të padiskutueshëm rivendosjen e pronës private mbi tokën bujqësore, procesi i privatizimit fatkeqësisht nuk rezultoi të ketë përfunduar ende plotësisht

edhe pse kanë kaluar 10 vjet. Në këtë proces të tejzgjatur kanë ndikuar për keq një varg vështirësish dhe kundërshtimesh, ndërmjet të cilave pretendimet e ish-pronarëve të shpronësuar nga Reforma Agrare përbëjnë ndoshta problemin më të mprehtë e më të vështirë për t'u zgjidhur, duke ushtruar kështu ndikimin më serioz në pengimin e krijimit dhe të funksionimit të tregut të tokës.

Siç u përmend, ligji “Për tokën” nuk parashikonte që familjeve të shpronësuara nga Reforma Agrare t'u rikthehej e drejta e pronësisë mbi tokën, madje as edhe pjesërisht. Si reaktion ndaj këtij përjashtimi lindi një lëvizje e fuqishme kundërshtuese që erdhi duke u fuqizuar gjatë procesit të zbatimit të ligjit. Ish-pronarët krijuan shoqatën e tyre të quajtur “Pronësi me drejtësi”, e cila në programin e saj dhe në të gjitha veprimtaritë që zhvilloi kërkonte rikthimin pa kushte dhe pa kufizime të pronësisë mbi tokën ish-pronarëve legjitimë.

Kuvendi që doli nga zgjedhjet e marsit 1992 dhe Qeveria që u votëbesua prej tij u përballuan menjëherë me problemin e mprehtë të ish-pronarëve, i cili u shndërrua në kusht për mbarëvajtjen e reformave në bujqësi dhe për krijimin e tregut të tokës. Për zgjidhjen e problemit ekzistonin tri alternativa:

- Kthim i plotë, pa asnjë kusht dhe kufizim i pronësisë mbi tokën bujqësore.
- Kompensimi i plotë me vlera monetare ose forma të tjera prone të barazvlerëshme me pronësinë mbi tokën bujqësore.
- Kompensim i pjesshëm me vlera monetare ose forma të tjera prone.

Kuvendi dhe Qeveria zgjedhën variantin e tretë duke e argumentuar këtë vendim me veçoritë dhe vështirësitë që kishte realiteti shqiptar. Në fillim të vitit 1993 u miratua ligji “Për kompensimin me vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore” (ligji nr.7699, datë 21.4.1993), i cili u pasua pas një viti me miratimin e ligjit “Për çmimin e tokës bujqësore për efekt kompensimi” (ligji nr.7836, datë 22.6.1994), me synimin që kompensimi të realizohej brenda një kohe të shkurtër.

Ligji për kompensimin u njihte të drejtën e pronësisë për efekt kompensimi në vlerë të tokës bujqësore ish-pronarëve, personave fizikë dhe juridikë, që e kanë pasur atë në pronësi në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945 “Për Reformën Agrare (neni 1). Kjo e drejtë u njihej edhe trashëgimtarëve ligjorë të tyre (neni 3). Pronësia duhej të vërtetohej me dokumente zyrtare ose me vendime të gjykatave (neni 4). Në rast se pronarët ose trashëgimtarët e tyre kishin përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr.7501 “Për tokën”, atëherë ata kompensohehin për prona deri në 15 ha. Ata që kishin pasur në pronësi më tepër se 15 ha, kompensoheshin për sipërfaqe shtesë sipas një formule të veçantë, por që në asnjë rast sipërfaqja që do të kompensohej nuk duhej të kalonte kufirin prej 43.5 ha (neni 8). Kompensimi do të bëhej në vlera monetare sipas një ligji të veçantë që do të miratohej pas 6 muajve, por vetëm nëpërmjet obligacioneve shtetërore të emetuara në lekë, të cilat shteti detyrohej t’i shlyente përmes pasurisë shtetërore deri më 31.12.1999. Pas këtimit afati shlyerja mund të bëhej edhe në *cash* (neni 12)

Miratimi dhe fillimi i zbatimit të ligjit nuk pati ndonjë efekt të dukshëm në zbutjen e qëndrimit të ish-pronarëve, të cilët vazhduan me të njëjtin intensitet përpjekjet për plotësimin e kërkesave të tyre maksimaliste. Po ashtu, pa ndonjë ndikim të dukshëm në zgjidhjen e problemit rezultuan edhe përpjekjet e tjera të Qeverisë për të përbushur kërkesat e ish-pronarëve. Kështu, në vitin 1995 Kuvendi miratoi ligjin nr.8047, datë 14.12.1995 “Për administrimin e tokës bujqësore të refuzuar”, sipas të cilit tokat që u refuzuan të merreshin në pronësi nga familjet fshatare gjatë zbatimit të ligjit “Për tokën” mund t’u shiteshin personave fizikë ose juridikë, duke u dhënë të drejtën e parablerjes me letra me vlerë, të përfituara nga kompensimi, ish-pronarëve të tokës bujqësore, me çmim të barabartë me vlerën e kompensimit. Por ky ligj nuk gjeti zbatim, sepse pjesa më e madhe e këtyre tokave nuk ishin produktive, ndodheshin larg qendrave të banuara, ishin të pavaditshme, por edhe sepse çmimi i tokës qe shumë i kontestueshëm.

Ngjarjet e vitit 1996 dhe në vitin pasardhës bënë që problemi i ish-

pronarëve të zbehej së tepërmi dhe të mos ishte më në rendin e ditës. Kuvendi dhe Qeveria e majtë që dolën nga zgjedhjet e qershorit të vitit 1997 u përballuan me shumë sfida që kishin të bënin me stabilizimin e gjithanshëm të vendit, por sidomos me domosdoshmërinë e vazhdimit të reformave të tranzicionit. Ndër përpjekjet e Qeverisë, një vend të rëndësishëm zuri edhe vazhdimi i procesit të krijimit të tregut të tokës, veçanërisht plotësimi i akteve ligjore dhe konsolidimi i institucioneve dhe infrastrukturës së nevojshme. Kështu u miratuan shpejt disa ligje të domosdoshme për funksionimin e tregut të tokës. Më 1.4.1998 u miratua ligji nr.8318 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pronë shtetërore”, dhe po atë muaj, më 30.4.1998 u miratua ligji nr.8337 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”. Është me interes të evidentohet preokupimi i Qeverisë për pretendimet e ish-pronarëve, i cili shprehet qartë në nenin 3 ku thuhet” “Toka bujqësore, pyjore, livadhet dhe kullotat pronë e shtetit, nuk mund të tjetërsohen deri në kompensimin e ish-pronarëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj”. Por hapi më i rëndësishëm drejt zgjidhjes së problemit të ish-pronarëve është përfshirja në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i angazhimit që shprehet në nenin 181, në pjesën e Dispozitave Kalimtare, që “kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryer para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.” Pra, më në fund, pas 7 vjetësh që nga koha e miratimit të ligjit nr.7501 “Për tokën”, i cili provokoi lindjen e problemit të ish-pronarëve të tokës bujqësore, u krijuan premiset për të gjetur një zgjidhje alternative, veç asaj të ofruar qysh në vitin 1993 për kompensimin në vlerë të pronave. Por entuziazmi i ish-pronarëve pas miratimit të Kushtetutës nuk vazhdoi gjatë, sepse Kuvendi dhe Qeveria për shkaqe të ndryshme (kriza e Kosovës, ndërrimet e shpeshta të përbërjes së Qeverisë etj.) nuk u angazhuan sa dhe si duhet për të përmbushur këtë detyrim

Kushtetutës. Kjo zvarritje e pajustificuar e detyroi shoqatën e ish-pronarëve që t'i drejtohet Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, që është edhe ngjarja e fundit në këtë histori të tejzgjatur të zgjidhjes së problemit të ish-pronarëve të tokës bujqësore në Shqipëri.

Pasoja më e drejtpërdrejtë e zvarritjes së zgjidhjes së problemit të ish-pronarëve të tokës bujqësore është pengimi i krijimit dhe zhvillimit të tregut të tokës në Shqipëri. Gjatë 10 vjetëve të tranzicionit ka pasur përpjekje serioze për të arritur këtë synim siç kanë qënë: krijimi i një sistemi bashkëkohor për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, “i planit të veprimit” dhe i miratimit të ligjit përkatës nr.7843, datë 13.7.1994. Po në këtë vit nisi edhe zbatimi i projektit për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, objektivi i përgjithshëm i të cilit është: “Krijimi i bazës institucionale për tregje dinamike, të drejta dhe të qëndrueshme të pasurisë së paluajtshme, të cilat të mbështesin tranzicionin efektiv drejt ekonomisë së tregut”. Por me gjithë punën e madhe të kryer deri sot, ende nuk mund të thuhet se në Shqipëri ka një treg dinamik dhe social për pasuritë e paluajtshme, pra edhe për tokën bujqësore. Ndër shkaqet që kanë penguar seriozisht arritjen e këtij synimi, një vend të rëndësishëm padyshim zë moszgjidhja e problemit të ish-pronarëve. Kjo ka shkaktuar zvarritjen e procesit të regjistrimit të pronave, sepse pronarët e rinj ndiejnë ende psiguri për zotërimin e pronës së tyre dhe, sidomos sepse është krijuar një psikozë se do të ketë ndryshime në ligjet që rregullojnë pronësinë pas miratimit të Kushtetutës. Është interesante të përmendet këtu rezultati i një anketimi të kryer në vitin 2001, ku në përgjigje të pyetjes: Cilat janë shkaqet e pasigurisë për pronësinë mbi tokën? 80 për qind e fermerëve të intervistuar (nga 952) u përgjigjen se “një pjesë e tokës sime pretendohet nga të tjerët”.

Nga sa u paraqit, me të drejtë lind pyetja: Çfarë duhet bërë për të kapërcyer këtë vështirësi serioze për të arritur krijimin dhe funksionimin real të tregut të tokës si një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e bujqësisë shqiptare në përputhje me kërkesat e ekonomisë së lirë të tregut? Po

përpiqemi të rendisim disa masa dhe propozime të cilat tashmë janë përpunuar në mjedise të administratës publike, të instituconeve publike dhe private, si dhe në mjediset akademike.

1. Është e domosdoshme dhe njëkohësisht e mundshme që të rishikohet edhe një herë tërësia e ligjeve që rregullojnë pronësinë mbi tokën bujqësore. Kjo është e arsyeshme të bëhet jo vetëm se ka një detyrim kushtetues, por edhe sepse gjatë 10 vjetëve të tranzicionit janë grumbulluar aq motive sa që të justifikojnë një ndërmarrje të tillë. Sidoqoftë, ne besojmë se në tërësinë e tyre këto ligje kanë qenë të drejta dhe kanë përmbushur dëshirat dhe vullnetin e shumicës dërrmuese të shqiptarëve. Rishikimi i tyre do të bëjë të mundur gjetjen e mundësive për të përmbushur edhe kërkesat e pjesës së pakicës që ka mbetur e pakënaqur, sepse në fund të fundit ky është edhe misioni i politikës: që të jetë arti i të mundshmes.

a) Në ligjin nr.7501 “Për tokën” ka nevojë të rishikohet mënjanimi prej tij i koncepteve dhe qëndrimeve që imponuan rrethanat politike dhe sociale të kohës kur u miratua; të rishikohet qëndrimi ndaj të drejtës së ish-pronarëve për pronësinë mbi tokën bujqësore dhe, sidomos, është e domosdoshme të bëhen përmirësime në aktet nënligjore që shoqërojnë ligjin, në mënyrë që të gjejnë pajtueshmëri ato veprime që kanë ndodhur gjatë zbatimit të ligjit, të cilat, megjithëse nuk kanë qenë në përputhje me të, sot janë pranuar si një realitet i pandryshueshëm.

b) Ligji nr.7699 “Për kompensimin me vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore” ka nevojë të rishikohet në thelbin e tij, duke parashikuar edhe forma të tjera të kompensimit. Gjithshtu, është e nevojshme të saktësohen më mirë subjektet që do të përfitojnë kompensim fizik; të përcaktohen sipërfaqet e tokës që do të përdoren për kompensim, si dhe limitet e sipërfaqeve që mund të përfitohen nga kompensimi; të përcaktohen afatet se kur do të nisë dhe kur do të përfundojë procesi i kompensimit fizik, si dhe përparësitë që duhen respektuar gjatë këtij procesi etj.

c) Në ligjin nr.7836 “Për çmimin e tokës bujqësore për efekt kompensimi”

është e nevojshme të rishikohet ndryshimi i çmimit për njësi të sipërfaqes së tokës, duke e përshtatur atë plotësisht me logjikën e ekonomisë së lirë të tregut.

2. Ka nevojë të ndërmerren disa veprime administrative, sepse përvoja e administratës shtetërore imponon rishikimin e procedurave të ndjekura gjatë gjithë periudhës së tranzicionit. Kështu, ka nevojë të kryhet një studim ezaurues për të përcaktuar saktësisht se sa janë reale pretendimet e ish-pronarëve të tokës bujqësore. Konfliktet midis pjesëtarëve të trungut familjar për pronësinë mbi tokën të mos jenë më midis tyre. Gjithashtu, është e nevojshme të gjendet edhe mekanizmi juridik dhe administrativ i verifikimit të vërtetësisë dhe drejtësisë së vendimeve gjyqësore që ka dalë nga procedura të dyshimta, të pambështetura në fakte bindëse dhe dokumente të rregullta pronësie, por në dëshmi subjektive.

3. Ka vend për përmirësime organizative, të cilat ta bëjnë procesin e kthimit dhe të kompensimit sa më korrekt, sa më efektiv dhe pa kontestime. Në proces është e nevojshme që të angazhohen edhe organizata joqeveritare, të cilat jo vetëm që do të kontribuonin në rritjen e efektivitetit të punës, por sidomos do të rritnin mjaft besimin e ish-pronarëve.

4. Përfshirja e politikës në proces është mëse e domosdoshme për të krijuar sfondin e nevojshëm për suksesin e reformës në fushën e pronësisë dhe të funksionimit të tregut të tokës bujqësore. Organizimi i tryezave ndërpartiake për shqyrtimin politik të problemeve dhe arritja e konsensusit të nevojshëm do të bëjnë të mundur garantimin e stabilitetit dhe të vazhdimësisë së reformës pavarësisht nga forca politike që vjen në pushtet.

Procesi i kthimit të pronave pronarëve të ligjshëm, domosdoshmëri për zhvillimin e shoqërisë shqiptare

*Grupi i ekspertëve
Shërbimit Ligjor Falas (TLAS),
Cafod - Shqipëri*

1.RËNDËSIA E RREGULLIMIT TË DREJTË TË RESPEKTIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËS

a) E drejta e pronës , e drejtë themelore e njeriut

E drejta e pronës përbën një nga të drejtat themelore të njeriut. Rëndësia e saj ka diktuar edhe ndërtimin e mjeteve dhe mekanizmave mbrojtës të së drejtës së pronës nga çënimet që mund t’i shkaktohen asaj qoftë nga individë apo shtete të ndryshme. Ndërkombëtarizimi i marrëdhënieve shoqërore ka sjelle si pasoje edhe ndërkombëtarizimin e këtyre mekanizmave, që synojnë të mbrojnë këtë të drejtë. Ndër më efikaset ndër to, padyshim, vlerësohet Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. Parashikimi në këtë konventë jo vetëm i së drejtës së respektimit të së drejtës së pronës, por edhe i procedurave konkrete për realizimin e saj, i japin asaj statusin e një të drejte themelore të realizueshme.

Në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar, me rëndësi të posaçme është detyrimi për respektimin e Konventës, e cila është bërë edhe pjesë e së drejtës kombëtare, nëpërmjet Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. I rëndësishëm në këtë aspekt paraqitet detyrimi që shteti shqiptar

ka marrë përsipër në nenin 182 të Kushtetutës për “të nxjerrë ligje brenda tre vjetëve nga hyrja e Kushtetutës në fuqi, për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të Kushtetutës”.

b) Qëndrimi i drejtë ndaj problemit të pronës, kusht për stabilitetin e marrëdhënieve në shoqërinë shqiptare.

Rëndësia e trajtimit të drejtë të marrëdhënieve të pronësisë reflektohet në stabilitetin e marrëdhënieve shoqërore. Kjo lidhje kushtëzohet nga roli i pronës në zhvillimin e shoqërisë. Duke zënë një rol parësor në marrëdhëniet shoqërore, marrëdhëniet e pronësisë determinojnë këto raporte në atë masë sa që stabiliteti në shoqëri nuk mund të mos shihet i lidhur ngushtë me këto marrëdhënie. Kjo lidhje është kaq e ngushtë sa që nuk e teprojmë nëse e lidhim kohëzgjatjen dhe vështirësitë e tranzicionit me zgjidhjen më të shpejtë dhe më të plotë të problemeve të pronësisë. Ne jemi të pranishëm çdo ditë në konfliktet e shumta që shoqërojnë shoqërine tona për shkak të mungesës së rregullimit ligjor apo rregullimit të paplotë sidomos në rastet e marrëdhënieve që krijohen mbi një pronë ndërmjet pronarit dhe personave të tjerë që mund të kenë fituar të drejta më pas mbi të.

II. PROBLEMET QË SHOQËROJNË ZHVILLIMIN E SHOQËRISE SHQIPTARE NË FAZËN AKTUALE LIDHUR ME MARRËDHËNIET E PRONËSISË

Pas përmbyesjes së komunizmit në Shqipëri u realizuan transformime të mëdha në shoqërinë shqiptare. Është fakt i pamohueshëm që gjatë kësaj kohe janë ndërmarrë reforma të karakterit kompleks legjislativ, organizativ etj., për të realizuar rivendosjen e të drejtave të njeriut të cënuara brutalisht gjatë viteve të regjimit komunist.

Në këtë kompleks reformash nuk mund të mohohet edhe përpjekja për t'u njohur ish-pronarëve të drejtën e pronësisë së mohuar. Por, pavarësisht nga hapat e ndërmarra deri tani, respektimi i të drejtave të cënuara ish-pronarëve ende mbetet i pavlerësuar në kufijtë që dikton rëndësia e kësaj të drejte themelore të njeriut dhe angazhimet e shtetit shqiptar, qoftë në planin kombëtar, ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Trajtimi i këtij problemi duhet të udhëhiqet nga koncepti se e drejta e pronës është e drejtë themelore, respektimin e së cilës shteti nuk e bën për t'u bërë favore pronarëve, por sepse ky respektim përfaqëson një detyrim me karakter juridikisht detyrues.

Në thelb, duhet pranuar se e drejta e pronës nuk është e drejtë absolute në kuptimin që lejohet kufizimi i ushtrimit të pakufizuar të tagreve që burojnë nga kjo e drejtë. Megjithatë, në tërësi është pranuar që kufizimet duhet t'i shmangen arbitraritetit dhe të lidhen realisht me një interes publik. Vetë "interesi publik" përfaqëson një fushë të gjerë, e cila është e vështirë të paracaktohet jashtë situatave konkrete të zhvillimit të një shoqërie. Por, megjithatë, duhet të ekzistojë predispozicioni që kjo fushë të mos zgjerohet në kurriz të të drejtave individuale siç është edhe e drejta e pronësisë, por as të kufizohet me frikën që të mos cënohen interesat individuale. Kërkesa për një ekuilibër sa më të drejtë duhet të udhëheqë kriteret, sipas të cilave ndërtohet legjislacioni përkatës që rregullon këto marrëdhënie.

Angazhimet e shtetit shqiptar për të respektuar Konventën lehtësojnë ndërtimin e legjislacionit përsa i përket marrëdhënieve të pronësisë në të ardhmen.

Vështirësia qëndron në hapat që duhet të ndërmerren lidhur me zgjidhjen e problemeve që janë krijuar për shkak të arbitraritetit të theksuar të mëparshëm të shtetit komunist në lidhje me pronën private. Ekzistenca e arbitraritetit është një fakt që nuk vihet më në dyshim. Diskutimi mund të përqëndrohet në hapat që duhen ndërmarrë për të zgjidhur pasojat që ka sjellë ky arbitraritet duke rivendosur në masë të pëlqyeshme të drejtat e cënuara të pronësisë.

Ky process “rehabilitimi” në mënyrë të pashmangshme do të kalojë nëpërmjet kthimit të pronave apo kompensimit. Diferenca ndërmjet këtyre dy formave të rehabilitimit të të drejtave të cënuara do të diktohet nga parimi i lartpërmendur për balancimin e të drejtave të pamohueshme pronarëve të cënuar me problemet e reja që do të shkaktonte një kthim i pakufizuar i pronave për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur mbi keto prona. E rëndësishme në gjetjen e kësaj balance është konsiderimi i saktë i raportit interes publik - interes privat. Kujdes i vecantë në këtë moment duhet t’i kushtohet sidomos ruajtjes nga prirjet diskriminuese të një grupi të popullsisë në raport me një grup tjetër për motive të ndryshme racore, politike etj.

Per ta ilustruar këtë opinion, do të paraqesim rastet kur në toka të cilat dikur shteti komunist ia kish marrë pronarëve të ligjshëm, aktualisht janë ndërtuar banesa të qytetarëve të ndryshëm. Në vetvete, përplasja e interesave të pronarëve të tokave dhe banorëve aktualë është lehtësisht e dukshme. Zgjidhjet që ofrohen janë të larmishme, por në përcaktimin e një zgjidhjeje që do të përmbushte balancën e lartpërmendur, mendojmë se duhet të qëndrojmë pikërisht raporti interes publik dhe interes privat. Kështu nuk mund të trajtohen me të njëjtin kriter, si banesat e ndërtuara në zona “masive”, me ato të ndërtuara individualisht. Gjithashtu, nuk mund të përdoret i njëjti kriter vlerësimi për këto ndërtime, duke injoruar destinacionin e ndërtimit. Vetë rëndësia që ka për një familje një ndërtesë e destinuar për banim, nga një ndërtim tregtar apo industrial, përcakton edhe diferencën në mënyrën e vlerësimit të balancës së interesave.

Gjithashtu, do të ishte e papranueshme që prona të lira, që u janë marrë më parë ish-pronarëve në mënyrë arbitrare, të mos u kthehen atyre me argumentin se mbi këto toka është i nevojshëm një kontroll më i fortë administrativ, për shkak të rëndësisë strategjike që paraqesin për zhvillimin e turizmit në vendin tonë. Ky argument nuk është bindës, pasi kufizime të mënyrës së administrimit, shteti mund të realizojë edhe pa qenë vetë pronar.

I papranueshëm, në këndvështrimin e kufizimit të së drejtës së pronësisë vetëm për të mos çenuar një interes tjetër të rëndësishëm me rëndësi shoqërore, është edhe kufizimi që përcakton ligji i tanishëm në madhësinë e sipërfaqes së tokës së lirë që i kthehet pronarit të ligjshëm. Nëse një pronë është e lirë dhe kthimi i saj nuk krijon konflikt interesash me grupe të tjera të popullsisë, është i pavend kufizimi i kthimit vetëm pjesërisht i pronës pronarit të cilit i është marrë më parë padrejtësisht.

Një problem i rëndësishëm që shoqëron në mënyrë të pashmangshme këtë proces, është edhe ai që lidhet me angazhimet juridike të Shqipërisë në raport me Konventën.

Duke iu referuar praktikës gjyqësore të Strasburgut, vihet re një trajtim i diferencuar i rivendosjes së të drejtave të çenuara të pronësisë, duke u mbështetur në mënyrën e marrjes së pronës.

Ndërsa për marrjen e pronës në bazë të një veprimi të bazuar në një ligj të kohës, kjo Gjykatë ka pranuar mungesën e veprimit detyrues të Konventës, përse i përket marrjes së pronës në kundërshtim me ligjin ekzistues, në kohën e “marrjes”, Gjykata ka pranuar shtrirjen e efekteve të Konventës me argumentin se “humbja e pronës është një akt që zgjat dhe që ndjehet edhe tani pas miratimit të Konventës, duke vazhduar dhunimin e saj”.

Ky qëndrim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut duhet mbajtur parasysh në ndërtimin e një politike realiste dhe në pajtim me angazhimet juridike detyruese të marra përsipër nga shteti shqiptar. Pra, në planin e masave legjislative dhe organizative duhen marrë masa të shpejta për të rehabilituar të gjithë pronarët të cilëve u është marrë masa në mënyrë të paligjshme dhe, në të njëjtën kohë duhet studjuar mundësia e kthimit dhe kompensimit për pronarët të cilëve u është marrë masa sipas ligjeve në fuqi në kohën e marrjes. Pra, ky qëndrim i Gjykatës mund të vlejë vetëm për të diferencuar në kohë kategoritë e ndryshme të pronarëve dhe jo për diferencimin e tyre në këndvështrimin nëse duhet t’u rivendosen të drejtat e mohuara apo jo.

Nisur nga këndvështrimi i mësipërm i problemeve të pronarëve të cilët shteti komunist i ka zhveshur nga pronësia, TLAS-Cafod Shqipëri ka përgatitur edhe projekt –ligjin përkates me ndryshimet në legjislationin e deritanishëm “Per kthimin dhe kompensimin e pronave”, i cili duhet vlerësuar si një kontribut modest në arritjen e objektivave që synon ky proces. Pa dashur të analizojmë në hollësi rregullimet që ofron ky draft, duam të sqarojmë se, në thelb, synohet pikërisht njohja e së drejtës së shkelur të pronësisë, e shoqëruar me procesin e kthimit të pakufizuar për rastet që vlerësohet se ky kthim nuk çënon interesa publike dhe kompensimin për ato raste në të cilat kthimi i pakufizuar do të krijonte çënime të interesave publike.

Një moment të rëndësishëm në këtë projekt-ligj zë edhe përcaktimi i kushteve organizative të përshtatshme për të bërë të mundur realizimin efektiv të të drejtave të premtuara nëpërmjet ligjit. Keto rregullime me karakter procedural çmohen si të rëndësishme, sidomos në shoqërinë shqiptare, e cila e vuan mungesën e një këndvështrimi të drejtë të domosdoshmërisë së zbatimit të ligjit në një shtet të së drejtës, siç pretendojmë se kemi ndërtuar edhe ne, pasi përvoja e deritanishme nuk është pozitive. Kështu, megjithëse ka dispozita “premtuese” për kompensimin e pronave që nga viti 1993, ende edhe sot ky proces ka mbetur i bllokuar pikërisht për shkak të mangësive të ligjit, në caktimin e afateve apo në parashikimin e procedurave konkrete për ta realizuar atë. Një fenomen i tillë vihet re edhe në kufizimin relativisht të gjatë në kohë, që po u bëhet pronarëve të ndërtesave për banim, të cilët gëzojnë këto banesa në kushte të kufizuara.

Këtë veprim e çmojmë si një veprim në interes të gjithë shoqërisë, pasi moszbatimi i ligjit për të kompensuar pronarët, nuk do të dëmtonte vetëm ata, por edhe ekonominë e Shqipërisë, për shkak të angazhimeve juridike të marra përsipër nga shteti shqiptar në planin ndërkombëtar.

Nëpërmjet këtij trajtimi, ne duam të sensibilizojmë opinionin mbi domosdoshmërinë e trajtimit të këtij problemi kaq të rëndësishëm për

shoqërinë shqiptare, në kushtet e sotme. Ne duhet të ndërgjegjësohemi për faktin se ky proces nuk mund të kalojë “në heshtje”. Nëse kërkojmë ndërtimin e një shoqërie në të cilën respektimi i të drejtave themelore të njeriut zë një vend parësor, duhet të këmbëngulim për zgjidhjen e çdo problemi, që ka të bëjë me cënimin e këtyre të drejtave. Zhvillimi i shoqërisë shqiptare është një proces në vazhdimësi dhe nuk mund të trajtohet si një zhvillim që fillon në pikën zero. Në mënyrë të pashmangshme, kjo shoqëri ka detyrimin të trajtojë në mënyrë të njëjtë të gjithë pjesëtarët e saj, përndryshe ne nuk mund të arrijmë synimin për ndërtimin e një shoqërie në të cilën sundon zbatimi i ligjit dhe i vlerave bazë, mbi të cilën janë ndërtuar gjithë shoqëritë moderne.

Ndryshimet kushtetuese në vendet ish-socialiste pas vitit 1989

Nga Dr. Xhezair Zaganjori

Ndër hapat e parë të rëndësishëm të ndërmarra në vendet ish-socialiste pas ndryshimeve demokratike të filluara në vitin 1989, ishte edhe miratimi i një legjislacioni të ri bashkëkohor. Natyrisht që në këtë kuadër vend qendror zinte miratimi i kushtetutave të reja. Sigurisht që edhe më parë të gjithë këto vende kishin kushtetutat e tyre. Megjithatë, as që mund të bëhet fjalë për kushtetuta të standardeve demokratike. Kushtetutat e vendeve komuniste ishin vetëm mjete mashtrimi e propagande, përmes të cilave synohej të përlegjej dhe të ruhej me çdo kusht sistemi i shtypjes dhe i shfrytëzimit ndaj masave të gjëra të popullsisë.

Ato ndalonin kategorikisht pluralizmin politik dhe lirinë e fjalës e të mendimit, shpallnin si ideologji të vetme marksizëm-leninizmin, ndalonin besimin fetar dhe institucionet fetare, shpallnin parimet e dikaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave, të cilët praktikisht përdoreshin për të ushtruar dhunë e presion ndaj popullsisë, për zhdukjen e kundërshtarëve të regjimit etj. Në fushën e organizimit shtetëror garantohej përparësia dhe kontrolli absolut i partisë komuniste mbi çdo qelizë të shtetit e shoqërisë. Në fushën e ekonomisë me kushtetutë deklaroheshin parime absurde, të cilat vetëm pengonin zhvillimin dhe ecjen përpara. Një nga shembujt më të këqinj dhe më të skajshëm ka qenë Kushtetuta e vendit tonë e miratuar në vitin 1976.

Kushtetutat e reja të miratuara në vendet e Europës Qendrore e Lindore pas vitit 1989 kishin, në të kundërt, detyrën e vështirë të hidhnin bazat dhe të krijonin kushtet e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e një shoqërie pluraliste dhe të një demokracie parlamentare të standardeve perëndimore. Këto objektiva, në përgjithësi, janë realizuar me sukses prej tyre. Pothuajse në të gjitha rastet, në kushtetutat e reja hiqet përfundimisht dorë nga organizimi shtetëror socialist dhe deklarohen e garantohen pluralizmi politik, ekonomia sociale e tregut, zgjedhjet e lira, të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, ndarja e pushteteve etj.

Marrë në tërësi, duke pasur edhe ndikimin dhe shembullin pozitiv të kushtetutave perëndimore, në përgjithësi kushtetutat e reja të vendeve të Europës Qendrore e Lindore synojnë dhe marrin parasysh tri elemente thelbësore, që, si rregull, duhet të ketë çdo kushtetutë demokratike bashkëkohore:

- a) të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- b) rindërtimi dhe ristrukturimi i pushtetit politik, në përputhje me parimet e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës dhe
- c) krijimi i një sistemi të pavarur gjyqsor.

Le t'i trajtojmë shkurtimisht secilin prej këtyre elementeve:

- a) Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut

Ashtu si në shumicën e kushtetutave demokratike të miratuara veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, edhe në kushtetutat më të fundit të vendeve të Europës Qendrore e Lindore zë vend tepër të rëndësishëm evidentimi dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në këtë drejtim vihet re dukshëm një bashkërendim dhe harmonizim mjaft i mirë i normave kushtetuese të çdo vendi të veçantë me normat dhe kërkesat që përmbajnë marrëveshjet dhe aktet më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, të hartuara kryesisht nën kujdesin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Europës. Për më tepër, kushtetutat

e reja kanë pasur avantazhin të kenë parasysh dhe të pasqyrojnë edhe përvojën dhe punën e mirë që është bërë në mbrojtje të të drejtave të njeriut nga Komisioni dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut më qendër në Strasburg.

Sidoqoftë, evidentimi i qartë i të drejtave të njeriut në kushtetutat e miratuara vitet e fundit në vendet e Europës Qendrore e Lindore nuk duhet të mbivlerësohet. Është fakt i pamohueshëm se, pavarësisht nga deklaratimet dhe garancitë kushtetuese, rastet e cënimit dhe shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vendet ish-komuniste janë mjaft të shpeshta në jetën e përditshme. Në këto kushte, aktualisht merr përparësi të veçantë krijimi i garancive sa më të plota institucionale dhe marrja e masave sa më efektive për realizimin në praktikë të këtyre të drejtave dhe lirive themelore. Po në këtë kuadër, rëndësi të madhe ka edhe mbrojtja më e mirë e këtyre të drejtave dhe lirive nga ana e gjykatave të pavarura, sidomos nga gjykatat kushtetuese.

Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e kushtetutave të reja të vendeve të Europës Qendrore e Lindore në fushën e të drejtave të njeriut është edhe deklarimi për detyrimin e angazhimit të shtetit në fushën e mbrojtjes dhe të mbështjetjes sociale. Është fakt se përgjegjësia sociale e shtetit pranohet sot si element i rëndësishëm kushtetues. Ndhima e shtetit për përballimin e problemeve të mprehta sociale është bërë kështu fushë mjaft e rëndësishme e veprimtarisë shtetërore edhe në vendet ish-socialiste. Megjithatë, me këtë rast ndoshta është e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet deklaratimit e synimit kushtetues me mundësitë reale të shtetit për të ndihmuar në përballimin e problemeve të shumta sociale. Kemi parasysh këtu sidomos prapambetjen e madhe ekonomike të trashëguar nga e kaluara, vështirësitë e krijuara për shkak të transformimeve dhe reformave ekonomike, inflacionin dhe shkallën e lartë të papunësisë në fazën e tranzicionit etj.

b) Rindërtimi dhe ristrukturimi i pushtetit politik

Me gjithë rëndësinë që kanë normat kushtetuese në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe deklaratimet mbi parimet bazë të krijimit dhe funksionimit të shtetit demokratik, është fakt se nga pikëpamja juridiko-kushtetuese ato nuk e kanë peshën dhe vlerën e normave që rregullojnë ndërtimin, organizimin dhe funksionimin e pushtetit shtetëror. Në fund të fundit, janë pikërisht këto norma që krijojnë kuadrin e domosdoshëm institucional për zbatimin e parimeve demokratike, si dhe njohjen dhe respektimin në praktikë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për këto arsye është e natyrshme vëmendja që iu kushtua që në fillim të transformimeve demokratike institucioneve kryesore të pushtetit shtetëror, bazuar në konceptet demokratike dhe përvojën pozitive të vendeve perëndimore.

Në fakt, siç kemi theksuar, në regjimin komunist i gjithë pushteti shtetëror në të gjitha sferat e tij i përkiste dhe ushtrohej praktikisht nga vetë partia komuniste. Të gjitha organet shtetërore dhe institucionet publike, përfshirë edhe parlamentin, qeverinë, gjykatat, prokuroritë etj., ishin krejtësisht të varura prej saj. Në këto kushte, roli i këtyre organeve në jetën politike të vendit ishte krejt formal. Prandaj reformat e para që u ndërmorën kishin për qëllim dhe objektiv kryesor vënien e organeve shtetërore në rolin e tyre tradicional, që është pikërisht ushtrimi i pushtetit shtetëror në përputhje me kushtetutën dhe ligjet. Koha kërkonte që ky ushtrim pushteti të legjitimohej e organizohej në përputhje me normat dhe parimet demokratike bashkëkohore.

Ndër kërkesat kryesore, që u morën parasysh në kushtetutat e reja, ishte krijimi në përgjithësi i një strukture të tilla shtetërore që afirmon dhe garanton diversitetin dhe pluralizmin e shoqërisë dhe që mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve. Në këtë kuadër, rëndësi e veçantë iu kushtua sidomos rregullimit sa më të plotë juridiko-kushtetues të çështjes së ndryshimit të pushtetit politik në mënyrë paqësore. Siç dihet, sistemi komunist nuk e pranon aspak një ndryshim i tillë. Çdo prirje për ndryshimin e pushtetit në

këto vende mbartëte gjithnjë më vete rrezikun për konfrontim të dhunshëm dhe rritjen e represionit ndaj masave të gjëra të popullsisë. Rastet e Shqipërisë (më 1945-1945-1946 etj.), Hungarisë (1956) Çekosllovakisë (1968), Polonisë (mesi i viteve '50 dhe fillimi i viteve '80 me Solidarnostin) etj. janë dëshmia më e qartë për këtë. Prandaj me të drejtë sot pranohet dhe deklarohet pothuajse në të gjitha vendet që janë në rrugën e demokracisë, se kemi të bëjmë me një sistem kushtetues demokratik vetëm atëherë kur ndryshimi i pushtetit shtetëror realizohet në formën dhe mënyrën e parashikuar nga kushtetuta, bazuar në zgjedhjet e barabarta e të lira që zhvillohen periodikisht në një shoqëri pluraliste.

Në kushtetutat e reja parashikohen ndryshime të shumta edhe përsa i përket rolit dhe vendit të parlamentit në jetën e përgjithshme shtetërore. Pothuajse në çdo rast është synuar që ai të kthehet nga organ formal në një mekanizëm tepër të rëndësishëm që mban peshën dhe përgjegjësinë kryesore për funksionimin sa më normal të demokracisë dhe për zhvillimin e vendit. Në përgjithësi parlamentit i janë dhënë funksione të shumta dhe mjete reale për ushtrimin efektiv të pushtetit shtetëror, të ngjashme më ato të vendeve perëndimore. Është pasur parasysh se vetëm kështu mund të bëhet fjalë për parlamentin si mbartës i vërtetë i interesave dhe i sovranitetit të popullit. Nga ana tjetër, marrja e një sërë masave për riorganizimin e brendshëm, ka pasur si qëllim kryesor ta bëjë sa më të frytshme veprimtarinë e organit përfaqësues.

Si rregull, aktualisht parashikohen krijimi i një administrate të përhershme në ndihmë të parlamentit, organizimi i grupeve parlamentare, zgjerimi e forcimi i komisioneve të përhershme dhe komisioneve të hetimit parlamentar etj.

Duhet theksuar, gjithashtu, se në disa raste kushtetutat e reja të vendeve të Europës Qendrore e Lindore parashikojnë krijimin e një parlamenti me dy dhoma (Dhoma e Deputetëve dhe Senati në Rumani, Dieta dhe Senati në Poloni, Dhoma e Deputetëve dhe Senati në Çeki etj.). Në shumicën e rasteve

të tjera është ruajtur sistemi i parlamentit me një dhomë, gjë që normalisht është karakteristike sidomos për vendet unitare. Në sistemet federale, krejt natyrshëm lind nevoja e krijimit edhe të një dhome të dytë, ku duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë shtetet ose njësitë që përbëjnë federatën. Në raste të tjera, megjithëse kemi të bëjmë me shtete unitare, dhoma e dytë imponohet për shkak të sipërfaqes së madhe të territorit dhe synimit të përfaqësimit në të, të gjitha rajoneve të tij. Rol të rëndësishëm në krijimin e një parlamenti me dy dhoma luan edhe tradita. Njohja e këtij sistemi dhjetëra e dhjetëra vite më parë në shumë shtete është diktuar nga domosdoshmëria e përfaqësimit në dhomën e dytë të një shtrese të caktuar të popullsisë (fisnikët, aristokracia e madhe, lordët etj.), të cilët duhet ta thonin patjetër fjalën e tyre mbi vendimet që merreshin dhe çështjet që shqyrtoheshin në dhomën e parë.

Të gjitha elementet e përmendura më sipër i mungojnë vendit tonë. Prandaj mendoj se kanë qenë të pajustificueshme përpjekjet që grupe dhe ekspertë të caktuar bënë më 1998 për të futur në kushtetutën tonë të re sistemin e parlamentit me dy dhoma. Adaptimi i këtij sistemi mendoj se në rastin tonë nuk do të kishte sjelle diçka pozitive. Aq më tepër kur dihet se qënia e parlamentit me dy dhoma nuk luan asnjë rol të rëndësishëm në kuadër të funksionimit sa më mirë të të ashtuquajturit shtet i së drejtës, sidomos përsa i përket njohjes dhe zbatimit të parimit të ndarjes së pushteteve. Në të kundërt, ka vërejtje se ky sistem shpesh vështirëson dhe ndërlikon marrjen e vendimeve, e bën të mërztishëm procesin legjislativ, bëhet shkak për bllokime e kriza politike, i hap rrugë kompromiseve për interesa të ngushta partiake, rrit dukshëm shpenzimet e buxhetit të shtetit etj.

Kushtetutat e reja të vendeve ish-socialiste parashikojnë ndryshime të rëndësishme edhe lidhur me krijimin, rolin dhe funksionin e kryetarit të shtetit. Gjer nga fundi i viteve '80, pothuajse në të gjitha vendet ish-socialiste ky funksion kryhej nga një organ kolektiv i tipit të Sovjetit Suprem që

ekzistonte në Bashkimin Sovjetik (te ne quhej Presidiumi i Kuvendit Popullor). Edhe ky organ ishte praktikisht krejt formal. Në vend të këtij, aktualisht, me kushtetutë parashikohet detyra e rëndësishme e presidentit të republikës, vendi dhe roli i të cilit ndryshojnë nga një rast në tjetrin. Natyrisht që kjo përcaktohet në varësi të kompetencave që i jepen dhe raporteve që me kushtetutë krijohen ndërmjet tij dhe organeve të tjera qendrore të pushtetit shtetëror.

Si rregull, zgjedhja e kryetarit të shtetit parashikohet të bëhet nga parlamenti (Shqipëri, Hungari, Çeki etj.) ose drejtpërdrejt nga populli me votim të përgjithshëm (Bullgari, Rumani, Poloni, Rusi etj.). Normalisht presidenti i republikës zgjidhet për 5 vjet. E drejta e rizgjedhjes në përgjithësi parashikohet të ushtrohet vetëm një herë.

Kushtetutat e reja i kushtojnë vëmendje tepër të veçantë edhe rregullimit të veprimtarisë së pushtetit ekzekutiv. Ashtu si dhe në vendet e tjera të demokracisë perëndimore, kjo detyrë e rëndësishme i ngarkohet qeverisë, në të cilën kryeministri luan një rol mjaft të rëndësishëm. Si rregull, parashikohet që kryeministri të emërohet nga presidenti i republikës mbi bazën e propozimit të bërë nga forca ose forcat politike që kanë shumicën në parlament. Parlamenti miraton më pas qeverinë në tërësi, si dhe programin politik të paraqitur prej saj. Kërkohej, gjithashtu, që veprimtaria e pushtetit ekzekutiv të zhvillohet gjithnjë në bazë dhe për zbatim të ligjit. Nga ana tjetër, ajo i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm të parlamentit etj. Kryeministri drejton dhe bashkërendon politikën e përgjithshme të të gjithë qeverisë, organizon zbatimin e buxhetit të shtetit, nënshkruan dhe denoncon marrëveshje ndërkombëtare etj. Nën drejtimin e tij qeveria zbaton politikën e brendshme e të jashtme, siguron ruajtjen e rendit publik etj.

c) Krijimi i një pushteti gjyqësor të pavarur

Kjo ka qënë një fushë tjetër e rëndësishme ku është dashur të bëhen ndryshime rrënjësore në kushtetutat e reja të vendeve të Europës Qendrore e Lindore. Është e natyrshme që pasi është bërë deklarimi për të drejtat dhe

liritë themelore, për vendosjen e demokracisë pluraliste dhe rindërtimin e organeve të pushtetit shtetëror, sigurimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe krijimi i kushteve për zbatimin në tërësi të parimeve të shtetit të së drejtës, bëhen ndër çështjet më të mprehta e më të brishta në ndryshimin e strukturave institucionale. Në saje të ndihmës e mbështetjes së dhënë veçanërisht nga Këshilli i Europës, si dhe huazimi në masë të konsiderueshme i normave kushtetuese dhe praktikave perëndimore mbi këto çështje, është bërë e mundur të gjenden zgjidhje relativisht të drejta dhe të hidhen hapat e parë pozitive në këtë drejtim.

Aktualisht pothuajse në të gjitha kushtetutat e reja deklarohet pavarësia e pushtetit gjyqësor; parashikohet krijimi i strukturave gjyqësore; përcaktohen procedurat, kushtet dhe mekanizmat për zgjedhjen, lëvizjen ose largimin e gjyqtarëve; etj. Ritheksojmë se, si rregull, të gjitha këto bëhen në funksion të njohjes dhe garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

Megjithatë, në praktikën e përditshme, në shumicën e vendeve të Europës Qendrore e Lindore e veçanërisht në vendin tonë, ende mbeten problem presionet dhe ndërhyrje e pushteteve tjera (të pushtetit ekzekutiv e pse jo edhe të pushtetit legjislativ) në organizimin dhe veprimtarinë e pushtetit gjyqësor, gjë që ka cenuar rëndë pavarësinë e tij. Kjo është vënë re jo vetëm në politikën e emërimeve, por edhe në problemet organizative dhe gjykimin e çështjeve konkrete etj. Prandaj marrja e masave për një pavarësi efektive të pushtetit gjyqësor ende mbetet detyrë imediate dhe tepër e rëndësishme për vendin tonë dhe për vendet e tjera ish-socialiste që janë në rrugën e transformimeve demokratike.

Nga një vështrim i përgjithshëm i kushtetutave të reja të vendeve të Europës Qendrore e Lindore nuk është vështirë të vërehet që në të gjitha rastet është synuar që parlamentit si organ me të vërtetë përfaqësues dhe mbajtës i sovranitetit të popullit, t'i njihet e t'i garantohet një vend qendror në të gjithë procesin e marrjes së vendimeve të rëndësishme politike në

shtet dhe shoqëri. Nga ana tjetër, përsërisim se kompetencat që i jepen dhe raportet që me kushtetutë krijohen ndërmjet parlamentit dhe organeve të tjera të pushtetit shtetëror, veçanërisht me kryetarin e shtetit dhe qeverinë, dëshmojnë se në shumicën e rasteve është pasur si qëllim vendosja e sistemit parlamentar të qeverisjes.

Kështu për shembull, pothuajse në të gjitha kushtetutat e vendeve ish - socialiste deklarohet ndër të tjera e drejta e parlamenteut për të miratuar emërimin e kryeministrit, si dhe qeverinë dhe programin e saj politik. Parlamenti ka gjithashtu të drejtë të kontrollojë punën e qeverisë; përmes votës së mosbesimit mund ta rrëzojë qeverinë dhe në vend të saj të zgjedhë një kryeministër tjetër etj.

Presidenti, shpeshherë në bashkëpunim dhe me miratim të qeverisë, në raste të caktuara mund të shpërndajë parlamentin dhe të vendosë organizimin e zgjedhjeve të reja. Kështu për shembull, në Poloni Presidenti mund ta shpërndajë Dietën (parlamentin) në tri raste: 1) Nëse brenda një periudhe prej tre muajsh nuk voton buxhetin 2) nëse brenda një periudhe prej tre muajsh nuk miraton Qeverinë dhe 3) nëse Parlamenti miraton një ligj, të cilin Presidenti e vlerëson se përbën pengesë për ushtrimin e kompetencave të tij. Nga ana tjetër, edhe Dietes i njihet e drejta të rrëzojë qeverinë (shih nenet 30 dhe 37 të Kushtetutës Polake të rinovuar më 1989) etj.

Edhe në Kushtetutën Rumune parashikohet që Presidenti i Republikës mund të shpërndajë Parlamentin në raste të caktuara dhe pasi është këshilluar më parë me kryetarët e të dy dhomave të Parlamentit dhe me kryetarët e grupeve parlamentare (neni 89 i Kushtetutës Rumune).

Sipas Kushtetutës Hungareze, Presidenti i Republikës mund të shpërndajë Asambleshën Kombëtare (Parlamentin) në dy raste: 1) Nëse gjatë mandatit të saj Asambleja Kombëtare e rrëzon Qeverinë të paktën 4 herë brenda një viti ose 2) kur mbaron afati i Qeverisë dhe Asambleja Kombëtare brenda 40 ditëve nga bërja e propozimit nuk zgjedh për Kryeministër personin e propozuar nga Presidenti i Republikës (neni 28/3 i Kushtetutës Hungareze).

Në Kushtetuten Bullgare parashikohet që Presidenti të mund të shpërndajë Kuvendin Popullor (Parlamentin) në rastet kur nuk arrihet marrëveshja për formimin e Qeverisë (neni 99 i Kushtetutës Bullgare) etj.

Mund të theksohet, gjithashtu, se me ndryshime të vogla, në të gjitha kushtetuta e reja të vendeve të Europës Qendrore e Lindore parashikohen mjete pak a shumë të njëjta të kontrollit parlamentar mbi qeverinë, qeverisë i njihen kompetenca të gjëra për drejtimin e përditshëm të veprimtarisë shtetërore; deklarohet mungesa e përgjegjësisë politike të kryetarit të shtetit në kryerjen e detyrave të tij; rregullohet pozita e presidentit të republikës herë si pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe herë si pushtet neutral dhe mbikëqyres ndaj pushteteve të tjera etj.

3. Kushtetuta dhe sistemi parlamentar i qeverisjes në Shqipëri

Është fakt se në Shqipëri, për shkak edhe të rrethanave dhe fateve historike, nuk u krijua pothuajse asnjëherë një traditë e mirëfilltë demokratike e parlamentare. Disa përpjekje fare të vogla që u bënë fillimisht në zgjedhjet parlamentare të vitit 1921 e më pas në periudhën e të ashtuquajturit revolucion demokratiko-borgjez të Fan Nolit, nuk arritën të realizohen e të zenë vend të dukshëm në jetën politike shqiptare.

Gjatë sundimit të Zogut padyshim që u arritën rezultate mjaft pozitive në konsolidimin e një shteti shqiptar modern dhe në krijimin e strukturave dhe institucioneve të rëndësishme shtetërore. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajti edhe Kushtetuta e miratuar në vitin 1928, si dhe në përgjithësi legjislacioni që u miratua më pas në bazë dhe për zbatim të saj. Në mjaft aspekte u huazuan zgjidhjet kushtetuese dhe legjislacioni bashkëkohor i vendeve më të zhvilluara perëndimore. Sidoqoftë, marrë në tërësi mund të thuhet me bindje së regjimi i vendosur nuk mund të konsiderohet aspak demokratik. Praktiki në Shqipëri ishte vendosur një regjim monarkik tepër autoritar, më përqendrim të madh të pushtetit shtetëror në duart e monarkut dhe të oborrit mbretëror. Sigurisht që nuk njihej dhe as që mund të bëhej fjalë për pluralizëm politik dhe për sistem parlamentar të mirëfilltë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, për rreth gjysmë shekulli, fatkeqësisht në Shqipëri u vendos një nga regjimet komuniste më totalitare e më çnjerëzore. I gjithë legjislacioni, sistemi shtetëror dhe institucionet, që në përgjithësi u huazuan nga ato të vendeve të tjera të lindjes, kishin si qëllim dhe synim kryesor mbijetesën e diktaturës së vendosur, shtypjen e masave të gjëra dhe eliminimin edhe fizik të çdo kundërshtari politik.

Kushtetuta e vitit 1946 është e para e miratuar pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Në këtë periudhë vendi ynë ishte praktikisht pothuajse nën varësinë e plotë të Jugosllavisë dhe Partisë Komuniste jugosllave. Për më tepër, kjo e fundit kishte diktuar edhe vetë krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare dhe vendosjen e Enver Hoxhës në krye të saj. Për rrjedhojë, natyrshëm, Kushtetuta e vendit tonë e vitit 1946 huazonte në masë të konsiderueshme Kushtetutën Jugosllave të asaj kohe. Ndryshimi më i dukshëm nga pikëpamja formale konsiston ndoshta në faktin se Kushtetuta Jugosllave njihte sistemin e parlamentit me dy dhoma, ndërsa Kushtetuta jonë atë me një dhomë të vetme.

E drejta e pronës në dritën e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut

Nga Dajena Pollo (Kumbaro)

Cilat janë parimet bazë dhe elementet përbërëse të së drejtës së pronës si një nga të drejtat themelore të njeriut? A mund të kufizohet ajo dhe në cilat raste dhe mbi bazë të cilave kritere?

Këto janë pyetje që, veçanërisht gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ngrihen shpesh nga juristë, avokatë, gjyqtarë, akademikë e studentë. Ndryshimi tërësor që pësoi sistemi politik dhe rendi juridik në Shqipëri pas fillimit të viteve '90, duke i vënë theksin parimit të ligjshmërisë ose shtetit të së drejtës, parashikon ndër të tjera respektimin e garantimin e së drejtës së pronës jo vetëm si një nga të drejtat dhe liritë themelore të individit, por edhe si element thelbësor përbërës i themelit të rendit juridik e i marrëdhënieve shoqërore. Shpeshherë çështjet e pronësisë kanë qenë në vëmendje të vendimmarrësve shqiptarë, juristëve, por edhe të qytetarëve të interesuar për këto çështje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo. Legjislati shqiptar për pronën, duke filluar me Kushtetutën, por edhe traktatet ndërkombëtare, kryesisht ato mbi të drejtat e njeriut, i kushtojnë një vend të veçantë respektimit të së drejtës së pronës. Por nga ana tjetër formulojnë edhe rastet kur ajo mund të kufizohet ose të privohet kundrejt një kompensimi të drejtë.

Vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ose Gjykatës së

Strasburgut, lidhur me të drejtën e pronës, pa dyshim, që kontribuojnë në shtimin e mendimeve autoritare në këtë fushë. Materialisht këto vendime kanë një rëndësi të madhe, duke pasur parasysh vendin që i jep Kushtetuta Shqiptare marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara¹, siç është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut². Për më tepër neni 17 i Kushtetutës parashikon se:

“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.”

Pra, Kushtetuta parashikon disa standarde e kritere për kufizimin e të drejtave dhe lirive, përfshirë edhe të drejtën e pronës, duke përcaktuar si standard minimal për respektimin e tyre ato të pasqyruara në Konventë. Gjykata e Strasburgut si autoritet i interpretimit të Konventës dhe Protokolleve të saj, në një mori çështjesh ka sgaruar kuptimin e kufizimeve dhe të privimeve të së drejtës së pronës. Ndonëse është e vështirë të bëhet një përmbledhje dhe paraqitje e linjave kryesore të argumentimit dhe formulimeve të zhdërvjellta juridike të kësaj Gjykate, duke pasur parasysh edhe faktin që janë dhënë vendime të ndryshme për çështje të ngjashme, në vijim po bëj një përpjekje të tillë, duke mos lënë mënjanë specifikat e rasteve të veçanta.

¹ Neni 122 i Kushtetutës parashikon: Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik... Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”.

² Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollet e saj është ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 dhe instrumentet e ratifikimit janë depozituar në datë 2.10.1996.

Siç mund ta vëre re edhe lexuesi, larmia e konflikteve, lidhur me të drejtën e pronës dhe tipet e ndryshme të ligjeve të brendshme që rregullojnë marrëdhëniet e pronësisë, nuk e kanë penguar Gjykatën që të shprehet në mënyrë të përgjithshme, të formulojë parime, të vendosë standarde e t'i bëjë ato të zbatueshme në konfliktet që i janë shtruar për zgjidhje.

E drejta e pronës në Konventë

Si një nga të drejtat themelore të njeriut, e drejta e pronës u përfshi në Nenin 1, të Protokollit 1³ të Konventës:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën për respektimin e pronës së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat pararendëse, sidoqoftë nuk cenojnë të drejtën e Shtetit për të miratuar ligje të tilla që i konsideron të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e tatimeve ose të kontributeve të tjera ose të gjobave.”

Interpretimi i Nenit 1

Në një sërë çështjesh⁴, Gjykata është shprehur se neni 1 i Protokollit 1 të Konventës përfshin tri rregulla. Rregulla e parë e formuluar në paragrafin e parë të nenit shpreh parimin e gëzimit paqësor të pronës. Rregulla e dytë, e cila përmbahet në fjalinë e dytë në të njëjtin paragraf parashikon se e drejta

³Protokollit 1 i Konventës me amendamentet e Protokollit 11 është nënshkruar në Paris në datë 20.3.1952. Nenet 1, 2, 3 dhe 4 të këtij Protokollit konsiderohen si nene shtesë të Konventës. Shih nenin 5 të Protokollit 1.

⁴Shih p.sh. Vendimet Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjet *James v. Britanisë së Madhe*, Series A nr.98, pp.29-30, par.37: *Immobiliare Saffi v. Italisë*, datë 28.7.1999, tek <http://hudoc.echr.coe.int/>

e pronës mund të privohet me respektimin e disa kushteve. Ndërsa rregulla e tretë e shkruar në paragrafin e fundit i njeh shteteve të drejtën që të kontrollojnë përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm. Megjithatë, Gjykata vë theksin se rregulla e dytë dhe e tretë duhet të interpretohen në frymën e parimit të përgjithshëm që përmbahet në rregullën e parë.

Siç shprehen në nenin 1, kushtet që përfshihen në rregullën e dytë në rastet e privimit të së drejtës së pronës, janë “parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare” dhe “kushtet e parashikuara nga ligji”. Gjykata ka interpretuar kuptimin e këtyre termave duke sqaruar se, së pari, *parimet e së drejtës ndërkombëtare* janë të zbatueshme vetëm për joshtetasit. Këto parime u zhvilluan në mënyrë të posaçme për të mbrojtur interesat e të huajve që nuk ndodhen në vendet e tyre të origjinës. Këtu përfshihet edhe parimi i mirënjohur i të drejtës ndërkombëtare për një kompensim të drejtë, të shpejtë dhe efektiv për shpronësimet e pasurisë⁵.

E diskutueshme është edhe çështja nëse fjala “askush” do të interpretohet se përfshin çdo njeri, pra përfshirë edhe shtetasit. Gjykata nga ana e saj është shprehur se ndonëse ky argument është i fortë nga ana gramatikore, ekzistojnë arsye bindëse për një interpretim të ndryshëm. Duke iu referuar Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve të vitit 1969, nenit 31, Gjykata shprehet se fjalët e një traktati duhet të interpretohen në kuptimin e tyre të zakonshëm, dhe interpretimi i frazës në një mënyrë të tillë që shtrin zbatimin e parimeve të së drejtës ndërkombëtare edhe për shtetasit, përtej sferës së zakonshme të zbatimit të tyre nuk është në përputhje me kuptimin e zakonshëm të termave të përdorura, përfshirë edhe kontekstin e tyre⁶.

⁵. *Supra note 4, çështja James*, para. 60.

⁶. *Ibidem* para. 61

Lidhur me interpretimin e shprehjes “*kushtet e parashikuara nga ligji*”, Gjykata ka theksuar që termat «ligj» dhe «i ligjshëm» në Konventë nuk bëjnë thjesht një referencë tek e drejta e brendshme, por lidhen gjithashtu edhe me cilësinë e ligjit duke kërkuar që ai të jetë në përputhje me parimin e ligjshmërisë ose shtetin e së drejtës⁷.

Qëllimi i ndërhyrjes

Gjykata në përgjithësi merr në shqyrtim ligjin ose masën me të cilën një shtet ndërhyr për të kufizuar, privuar ose kontrolluar ushtrimin e së drejtës së pronës dhe nxjerrjes së fryteve prej saj. Në përgjithësi deklarohet se qëllimi, të cilin ligji i brendshëm kërkon të arrijë, duhet të jetë legjitim. Pra, ky është edhe një nga testet nëpër të cilin kalon ligji i brendshëm para se të vlerësohet nëse ai përbën një shkelje ose jo të nenit 1 të Protokollit 1. Si qëllim legjitim Gjykata ka vlerësuar p.sh. ruajtjen e rendit publik, luftën kundër trafikeve të paligjshme, realizimin e politikave sociale ekonomike për krijimin e një drejtësie sociale, zhvillimit urban etj.

Interesi publik dhe liria e vlerësimit të autoriteteve shtetërore

Gjykata ka pohuar se privimi i pronës pa asnjë arsye dhe vetëm në përfitim të një personi privat nuk mund të konsiderohet “interes publik”. Megjithatë transferimi i detyrueshëm i pronës nga një individ te një tjetër, në varësi të rrethanave mund të përbëjë një mjet legjitim për nxitjen e interesit publik. Shprehja “interes publik” nuk mund të lexohet se prona e transferuar duhet të përdoret vetëm nga publiku i gjerë ose nga komuniteti në përgjithësi. Kështu marrja e pronës për zbatimin e një politike të llogaritur për të rritur drejtësinë sociale brenda komunitetit mund të përshkruhet sikur është në interes të publikut. Në veçanti, drejtësia e sistemit juridik që rregullon

⁷. Shih Vendimin në çështjen *Malone* të datës 02/08/1984, Seritë A No. 82, p.32, para. 67.

marrëdhëniet kontraktuale dhe të drejtën e pronës së palëve private është një çështje e shqetësimit publik dhe për këtë arsye masat legjislative që kanë për qëllim të sjellin këtë drejtësi, e kanë të mundur të jenë “në interes të publikut” edhe në rast se ato përfshijnë transferimin e detyrueshëm të pronës nga një individ te një tjetër⁸. Sipas Gjykatës, nxjerrja e një ligji, i cili mundëson marrjen e një prone për shkak të një politike legjitime sociale, ekonomike etj., mund të jetë në “interes publik” edhe nëse komuniteti i gjerë nuk e përdor ose e gëzon pasurinë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Dhe ky ligj nuk është *ipso facto* në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.

Para se të parashtrohen thëniet e Gjykatës për lirinë e vlerësimit të autoriteteve shtetërore, së pari duhet theksuar se liria e vlerësimit ose e diskrecionit të autoriteteve kombëtare në kontekstin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut është liria për të vepruar, manovruar⁹; ose hapësira e ndryshimit ose gabimit që organet e Strasburgut ia lejojnë institucioneve kombëtare legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore para se të shprehen për një derogim të këtyre autoriteteve nga Konventa¹⁰. Me fjalë të tjera liria e vlerësimit është hapësira që i lejohet shteteve anëtare të Këshillit të Europës në gjetjen e një ekuilibri ndërmjet një të drejte të garantuar nga Konventa dhe një kufizimi ose derogimi të lejueshëm. Në përgjithësi Gjykata ka heziturar që të anashkalojë diskrecionin e autoriteteve të brendshme për çështje që kryesisht kanë të bëjnë me kontrollin e përdorimit të pronës ose

⁸ Vendimi *James*, supra note 4, para 40-41.

⁹ Lockwood et al., «Working paper for the Committee of Experts on the Limitations Provisions - Symposium: Limitation and Derogation Provisions in the international Covenant on Civil and Political Rights,» 7 Human Rights Quarterly 35, 68, 1984.

¹⁰ Yourow, H.C., *The Margin of Appreciation Doctrine in the Dynamics of the European Human Rights Jurisprudence*, International Studies in Human Rights, Martinus Nijhoff Publishers, 1996, p 13.

të privimit të saj. Sipas Gjykatës, autoritetet e vendit kanë njohuri të drejtpërdrejta të shoqërisë së tyre dhe nevojave të saj më shumë se sa gjyqtarët ndërkombëtarë, prandaj janë në një pozicion më të favorshëm për të vlerësuar çfarë është “në interes publik”.¹¹ Në fakt vendimet që lidhen me shpronësimet përfshijnë zakonisht konsiderata politike, ekonomike dhe sociale, opinionet mbi të cilat në një shoqëri demokratike ndryshojnë gjerësisht. Për Gjykatën është e natyrshme që liria e vlerësimit që ka legjislatura në zbatimin e politikave sociale e ekonomike duhet të jetë e gjerë. Prandaj Gjykata e respekton gjykimin e legjislaturës me përjashtim të rastit kur ky gjykim është haptazi i pabazuar.¹²

Proporcionaliteti ndërmjet masës dhe qëllimit

Sipas Gjykatës është e rëndësishme që çdo ndërhyrje me legjislacion të brendshëm, duhet të sigurojë një ekuilibër të drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut. Synimi për të arritur këtë ekuilibër pasqyrohet në strukturën e nenit 1 në tërësi, përfshirë edhe paragrafin e dytë. Prandaj duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve që përdoren dhe qëllimeve që kërkohen të arrihen. Për të përcaktuar nëse kjo kërkesë është realizuar, Gjykata pranon se shteti gëzon një hapësirë vlerësimi si për zgjedhjen e mjeteve, ashtu edhe për të siguruar nëse pasojat e dispozitave ligjore justifikohen nga interesi i përgjithshëm. Ekuilibri i kërkuar nuk ekziston kur një personi i është dashur të mbajë «një barrë individuale dhe të tejkaluar»¹³. Kështu, sistemi i brendshëm duhet të përmbajë një sërë garancish proceduriale në mënyrë që të sigurojë që veprimi i sistemit dhe

¹¹ Vendimi *Hakansson dhe Sturesson* i datës 21/02/1990, Eur.Ct.H.R., Series A, no. 171-A; dhe Vendimi *James*, supra note 4, par. 46.

¹² Vendimi *James*, supra note 4, para. 46.

¹³ Vendimi *Sporrong dhe Lönnroth v. Suedisë*, Seritë A, no. 52, para. 69.

ndikimi i tij mbi të drejtën e pronës të mos jetë arbitrar dhe i paparashikueshëm.

Në sfera të tilla si strehimi, i cili luan një rol qendror në politikat sociale dhe të mirëqënies në shoqëritë moderne ose të zhvillimit urban, Gjykata e respekton gjykimin e legjislativit në përcaktimin e asaj që është interes i përgjithshëm, me përjashtim kur ai gjykim është haptazi i papabuar.

Disa çështje mbi të drejtën e pronës

Në vijim pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur disa çështje të Gjykatës së Strasburgut mbi të drejtën e pronës, për të krijuar një ide më të qartë se si parimet, kriteret e elementet e mësipërme zbatohen për llojet e ndryshme të konflikteve që i paraqiten Gjykatës.

*Çështja e Immobiliare Saffi v. Italisë (1999)*¹⁴

Faktet

Firma e ndërtimit I.B. ishte pronare e një apartamenti në Livorno të Italisë, të cilën ia kishte dhënë me qera L.B. Në një letër të datës 20.4.1983, informoi qeramarrësin se kishte ndërmend ta përfundonte kontratën e qirasë më datë 31 dhjetor 1983 dhe i kërkoi atij që ta zbraste apartamentin në atë datë. Në nëntor I.B. i dërgoi një lajmërim qeramarrësit për dhënien fund të kontratës, por ai sërish refuzoi të largohej. Firma e ndërtimit iu drejtua një gjyqtari në Livorno. Gjykata urdhëroi qeramarrësin që të largohej nga banesa deri në 30.9.1984. Pas shumë përpjekjesh, urdhri i Gjykatës refuzohej të ekzekutohej nga qeramarrësi. Immobiliare Saffi u bë pronare e banesës në vitin 1988. Në periudhën dhjetor 1988 derinë janar 1996, kjo agjenci bëri shumë përpjekje për të rifituar posedimin e saj mbi banesën, por pa sukses,

¹⁴ Vendimi Immobiliare Saffi, supra note 4.

edhe pasi në bazë të ligjit në fuqi, për konflikte të asaj natyre paditësi nuk kishte të drejtë të merrte ndihmën e policisë. Ligji ekzistues u ndryshua në mars të vitit 1989, por ndihma e policisë për ekzekutimin e urdhrave të gjykatës për konfliktet e pronësisë jepej në bazë të disa kushteve, të cilat Imobiliare Saffi nuk i përmbushte (pronari duhej të kishte nevojë urgjente për banesën për veten ose familjen e tij). Kështu, në shtator të vitit 1993, Imobiliare Saffi i drejtohet Komisionit, ndër të tjera për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 nga Italia. Kompania arriti ta merrte apartamentin në vitin 1996 me vdekjen e qeramarrësit. Para Gjykatës së Starsburgut, paditësi u shpreh se paafësitia e zgjatur - nëpërmjet mungesës së ndihmës së policisë për të rimarrë në posedim apartamentin, ishte një dhunim i të drejtës së pronës.

Gjykata hodhi poshtë pretendimin e paditësit se ajo që kishte ndodhur ishte një shpronësim *de facto*, megjithatë, meqënëse në bazë të legjislacionit të brendshëm qeramarrësi vazhdonte ta mbante banesën, mund të thuhet se kishte kontroll mbi përdorimin e pasurisë në kuptim të nenit 2, paragrafi 1.

Lidhur me qëllimin e nxjerrjes së dispozitave ligjore në Itali, Gjykata njohu se nxjerrja e njëkohshme nga shtëpia e shumë qiramarrësve do të shkaktonte një tension shoqëror të konsiderueshëm dhe do të rrezikonte rendin publik. Pra, rrjedhimisht, legjislacioni në fjalë kishte një qëllim legjitim, siç e kërkonte edhe neni 1, paragrafi 2.

Gjykata vuri re se Italisë, për trajtimin e problemeve të strehimit i duhej të zbatonte masa emergjente për të kontrolluar rritjen e qirave dhe rritjen e afateve të kontratave të qirasë që ekzistonin. Masat ligjore mund të konsideroheshin si të arsyeshme për të arritur një qëllim legjitim, duke synuar që të vendosej një ekuilibër ndërmjet interesave të komunitetit dhe të drejtave të pronarëve. Megjithëse çështjet jourgjente, si ajo e *Imobiliare Saffi*, duhej të ishin zgjidhur deri në fund të vitit 1993, kjo nuk ndodhi. Gjykata ishte e mendimit se në parim, një sistem, i cili vendos një pezullim të përkohshëm të ekzekutimit të urdhrave të gjykatës në favor të pronarit, në vetvete nuk

kritikohet, duke pasur sidomos parasysh lirinë e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e vendit në bazë të nenit 1 paragrafi 2. Megjithatë, ky sistem mban mbi vete rrezikun e vendosjes së barrave të rënda mbi të drejtën e pronarit për të gëzuar pronën e vet. Gjykata vuri re se sistemi italian vuante nga një shkallë jofleksibiliteti, pasi parashikonte që çështjet në të cilat qiraja përfundohet për arsye se pronari ka nevojë urgjente për ta rimarrë banesën për vete ose për familjen e vet, duhej t'i jepej gjithnjë përparësi. Kështu, pas janarit të vitit 1990, urdhrat e Gjykatës për çështjet jourgjente, në praktikë nuk u ekzekutuan kurrë. *Immobiliare Saffi* u la kështu në një gjendje pasigurie për posedimin e banesës. Gjithashtu, asgjë nuk u tregua që qeramarrësi, i cili posedonte banesën e paditësit, të meritonte ndonjë mbrojtje të veçantë. Si rrjedhojë Gjykata gjeti një shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 nga Italia.¹⁵

Çështja Phocas v. Francës (1996)

Faktet

Në çështjen *Phocas v. France*¹⁶, paditësi u ankua se kufizimi që i ishte vendosur mbi të drejtën e pronës për shkak të një skeme për përmirësimin e kryqëzimeve të rrugëve ku ndodhej dhe prona e tij, përbënte një shkelje të së drejtës së pronës. Z. Phocas pretendonte se gëzimi i plotë i pronës prej tij ishte bërë objekt i një sërë ndërhyrjesh nga autoritetet, si në moslejimin e ndërtimeve të reja mbi pronë, ashtu edhe për shpronësimin. Phocas i paraqiti Gjykatës pretendimin se autoritetet franceze kishin bërë një shkelje të nenit 1, Protokollit 1.

Në vendimin e saj, Gjykata shqyrtoi nëse ishte vendosur një ekuilibër i drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe

¹⁵ Një vendim të ngjashëm gjykata dha edhe në çështjen *Scollo v. Italisë*, datë 28/09/1995, te <http://hudoc.echr.coe.int/>.

¹⁶ Vendimi *Phocas*, i datës 23/04/1996, Eur.Ct.H.R. Raporte dhe vendime 1996-II.

mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut. Sipas Gjykatës, ndërhyrja në fjalë ishte hartuar me qëllim që të mundësonte realizimin e një skeme të zhvillimit urban. U deklarua sërish se shtetet gëzojnë një liri të gjerë vlerësimi për të implementuar politikën e tyre mbi planifikimin urban dhe në këtë rast skema në fjalë i përgjigjej nevojave të interesit të përgjithshëm¹⁷. Gjykata, gjithashtu, u shpreh se, megjithëse nga ana e autoriteteve pati vonesa në përgjigjen e aplikimeve të Z. Phocas për shpronësimin me anë të blerjes së pasurisë së tij nga shteti, braktisja e procedimeve u bë nga vetë pronari i cili nuk pranoi ofertën e blerjes dhe më pas e paraqiti çështjen në gjykatën e shpronësimeve jashtë afatit ligjor. Pra, procedurat e parashikuara në të drejtën e brendshme siguronin një mjet të mjaftueshëm për të siguruar mbrojtjen e të drejtës për një gëzim paqësor të pronës së vet. Në përfundim Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 nga ana e Francës.

*Çështja Air Canada v. Britanisë së Madhe (1995)*¹⁸

Faktet

Një avion i kompanisë Air Canada i drejtuar për në Tajlandë, u sekuestrua nga autoritetet angleze në mënyrë të përkohshme deri sa të paguante gjobën e vendosur nga zyra e tatim- taksave, pasi në bord iu gjet një sasi e madhe kanabis. Pasi kaloi shkallët e brendshme të gjykimit, kompania iu drejtua Gjykatës së Strasburgut për t'u shprehur se Britania e Madhe kishte cenuar të drejtën e pronësisë së kompanisë dhe për këtë arsye kishte shkelur nenin 1 të Protokollit 1.

Gjykata ishte e mendimit se në këtë rast kishte të bënte me një kufizim të së drejtës së pronës, meqënëse nuk kishte një transferim të saj (pronës).

¹⁷ *ibidem*. p.542, para 54-55.

¹⁸ Vendimi *Air Canada* i datës 05/05/1995, A316-A.

Sekuestrimi nga zyra e tatim-taksave ishte një mjet që përbënte një ushtrim kontrolli mbi përdorimin e avionit nga kompania ajrore.

Lidhur me çështjen e ekuilibrit ndërmjet interesit publik, i cili në këtë rast ishte lufta kundër trafikëve të paligjshme dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga njëra anë dhe proporcionalitetit ndërmjet mjetit të përdorur dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, Gjykata u shpreh se

“... sekuestrimi i avionit të kompanisë dhe kthimi i tij pas pagimit të gjobës përbënin pa dyshim masa të jashtëzakonshme, të cilat u përdorën për të sjellë një përmirësim në procedurat e sigurimit të kompanisë. Masat u morën pasi u gjetën në bordin e avionit 331 kg fara kanabis. Për më tepër ky incident ishte i fundit në një seri problemesh sigurimi të pretenduara, për të cilat Air Canada ishte njoftuar...¹⁹ ...Me këtë sfond ngjarjesh, nuk ka dyshim se masat e marra ishin në përputhje me interesin e përgjithshëm të luftës kundër trafikimit ndërkombëtar.”²⁰

Gjykata, gjithashtu, u shpreh se sasia e madhe e kanabis-it e gjetur, vlera e saj e madhe në tregun joformal, vlera e madhe e avionit të sekuestruar dhe kthimi i tij kompanisë përkundrejt pagesës së një shume 50, 000 pound, nuk ishte në disproporcion me qëllimin që duhej të arrihet. Prandaj Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 nga Britania e Madhe.

*Çështja Raimondo v. Italisë (1994)*²¹

Faktet

Ndaj Raimondos, një sipërmarrës italian ndërtimesh, u fillua procedimi penal nga një gjykatë e brendshme italiane, pasi kishte dyshime se i përkiste

¹⁹ *ibidem* para. 43

²⁰ *ibidem* para.42

²¹ Vendimi *Raimondo* i datës 22/02/1994, A281-A.

një organizate mafioze. Për rrjedhojë pasuria iu sekuestrua dhe një pjesë iu konfiskua. Pas përfundimit të shkallëve të gjykitimit të brendshëm, çështja u paraqit para gjykatës së Strasburgut, së cilës iu kërkua që të shprehej në favor të shkeljes nga ana e Italisë të së drejtës së pronës, që përbënte një shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.

Gjykata u shpreh se sekuestro në këtë rast ishte një masë paraprake për të siguruar që pasuria, e cila ishte fryt i veprimtarive të paligjshme të kryer në kurriz të komunitetit, të mos riinvetohej për të vazhduar veprimtarinë e paligjshme. Masa justifikohet nga interesi i përgjithshëm dhe duke pasur parasysh fuqinë e madhe ekonomike të një organizate shume të rrezikshme si mafia, nuk mund të thuhet se marrja e saj (masës) në atë fazë të procedimit ishte jodisproporcionale me qëllimin që kërkohet të arrihej. Ndërsa për konfiskimin, Gjykata u shpreh se, megjithëse ai përbënte një privim nga posedimi, ai ishte në përputhje me interesin e përgjithshëm. Sipas saj, konfiskimi ishte një mjet efektiv dhe një armë e nevojshme për të luftuar krimin e organizuar. Prandaj ishte proporcional me qëllimin. Si përfundim u gjet se masat e marra nga Italia nuk përbënin një shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.

*Çështja Mellacher dhe të jerët v. Austrisë*²²

Faktet

Paditësit ishin pronarë banesash të cilat i kishin lëshuar me qera në bazë të kontratave të qirasë para vitit 1981, kohë kur Austria miratoi një ligj (Akti i qirasë) i cili reduktonte tarifat e qirave në bazë të kategorizimit të banesave sipas cilësisë së tyre. Paditësit parashtruan pretendimin se ky Akt përbënte një shkelje të së drejtës së pronës sipas nenit 1, Protokollit 1.

²² Vendim *Mellacher* i datës 19/12/1989, A 169.

Gjykata u shpreh se në këtë rast zbatohet paragrafi i dytë i nentit 1, i cili i njeh shteteve të drejtën që të miratojnë ligje të cilat kontrollojnë ushtrimin e të drejtës së pronës në dobi të interesit të përgjithshëm. Veçanërisht në fushën e strehimit, i cili është një problem kryesor në shoqëritë moderne. Prandaj edhe legjislativi ka një liri të gjerë veprimi. Akti i Qirasë i vitit 1981 kishte si qëllim që të kufizonte ndryshimet e tejkaluara dhe të pajustificuara në tarifatat e qirave, si dhe të luftonte spekulimet nga ana e pronarëve. Gjykata pranoi që Akti në fjalë i shërbente interesit të përgjithshëm.

Lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes, Gjykata u shpreh se, megjithëse këto masa i vendosin disa pronarë banesash në kushte të pafavorshme në krahasim me të tjerët, nuk mund të thuhet se akti në fjalë është joproporcional ose i papërshtatshëm. Kur u kalua akti, legjislativi ishte i shqetësuar që t'i reduktonte tarifatat e qirave në një masë që të ishin më të pranueshme nga shoqëria, si dhe të inkurajonte përmirësimin e standardeve të banesave. Në dritën e të gjitha këtyre argumenteve, Gjykata u shpreh se Austria nuk kishte shkelur dispozitat e nenit 1, të Protokollit 1.

*Çështja James dhe të tjerët v. Britanisë së Madhe (1986)*²³

Faktet

Paditësit pretendonin se transferimi i detyrueshëm i pronës së tyre në bazë të Aktit të Qirasë të vitit 1967 përbënte një shkelje të Nenit 1, Protokollit 1 të Konventës. Sipas tyre ky akt ndërhynte në marrëveshjet ndërmjet qiramarrësve dhe qiradhënësve, të cilat ishin përfunduar para hyrjes në fuqi të këtij akti; i detyronte pronarët që të shisnin pronat e tyre kundër vullnetit të disa personave privatë që ishin qiramarrës afatgjatë; dhe i detyronte pronarët t'i shisnin me një çmim më të ulët se vlera e vërtetë e pasurisë në treg, etj.

²³ Supra note 4.

Gjykata u shpreh se liria e vlerësimit që kanë ligjvënësit për të përcaktuar politikat ekonomike dhe shoqërore është e gjerë dhe Gjykata e respekton gjykimin e ligjvënësit lidhur me përcaktimin e interesit publik. Marrja e një prone për shkak të një politike legjitime sociale, ekonomike etj., mund të jetë në “interes publik” edhe nëse komuniteti i gjere nuk e përdorë ose e gëzon pasurinë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjykata vendosi se legjislacioni mbi qeratë nuk ishte *ipso facto* në kundërshtim me nenin 1, të Protokollit 1, prandaj më tej u vlerësua nëse ai ishte në përputhje me kërkesat e tjera të fjalisë së dytë të nenit 1, paragrafi 1.

Duke u ndalur në çështjen e lirisë së vlerësimit të autoriteteve të vendit, gjykata rikonfirmoi se ata kanë njohuri të drejtpërdrejta të shoqërisë së tyre dhe nevojave të saj më shumë se sa gjyqtarët ndërkombëtarë, prandaj janë në një pozicion më të favorshëm për të vlerësuar çfarë është “interes publik”.

Strehimi i popullsisë konsiderohet si një nga nevojat kryesore të shoqërive moderne, rregullimi i së cilës nuk mund të lihet krejtësisht në dorë të forcave të tregut. Prandaj edhe ligjvënësit ndërhyjnë për të krijuar një drejtësi më të madhe sociale, edhe nëse legjislacioni i nxjerrë ndërhyt me marrëdhëniet ekzistuese kontraktuale ndërmjet palëve private. Qëllimi që kërkon të arrihet nga legjislacioni mbi reformat e qirasë u konsiderua si legjitim.

Gjykata, gjithashtu, vlerësoi se marrja e një prone për një interes publik, duhet të bëhet me kompensim; e kundërta mund të justifikohet vetëm në situata të jashtëzakonshme. Sipas saj mbrojtja e të drejtës së pronës do të ishte krejtësisht e pamundur dhe joefektive ose e rreme në mungesë të një parimi ekuivalent. Është e qartë se termat e kompensimit tregojnë nëse legjislacioni i brendshëm ka vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të ndryshëm dhe veçanërisht nëse ai nuk vendos një barrë disproporcionale mbi pronarin»²⁴. Gjykata u shpreh se ligji parashikonte një procedurë kompensimi, e cila ishte e tillë që nuk përbënte një shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 nga ana e Britanisë së Madhe.

²⁴ Shih edhe Vendimin *Sporrong dhe Lönnroth v. Suedisë, Seritë A*, no. 52, para. 69 dhe 73.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Nga Filip Lako

Kjo rubrikë synon dhënien e një informacioni mbi legjislacionin e miratuar rishtazi, duke patur parasysh se njohja fillestare e legjislacionit përbën një nga elementet vitale të një shoqërie demokratike. Lidhja midis qytetarëve dhe qeverisë së tyre është e fortë vetëm atëhere kur shqetësimet e tyre, pra, të publikut pasqyrohen në legjislacionin përkatës. Qytetarët që e konsiderojnë qeverinë e tyre si legjitime, ka më shumë të ngjarë që t'i binden edhe ligjeve të saj. Në të njëjtën kohë, synohet t'i vihet në ndihmë subjekteve publike dhe private që “konsumojnë” ligje për një kuptim të shpejtë dhe objektiv të legjislacionit të miratuara rishtazi në Kuvend.

Ligji nr.8748, datë 1.3.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Panhellenic Exportes Association për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë”” Me këtë ligj ratifikohet Marrëveshja e cila ka si subjekt konsolidimin e borxheve për shumën e papaguar të faturave dhe interesat mbi këto shuma që rrjedhin nga transaksionet tregtare të përfunduara para 31.12.1991, të mbetura të papaguara deri më 20.10.2000. Marrëveshja ka në mënyrë të detajuar emrin e kompanisë kreditore, shumën e faturës të papaguar dhe masën e interesit. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 7.4.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.9 të vitit 2001, faqe 281. Bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr.8749, datë 1.3.2001 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik” Sipas ligjit të lartpërmendur objekti i punës së këtij shërbimi është parandalimi, zbulimi dhe dokumentimi i veprimtarisë kriminale që kryhet nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera të Ministrisë së Rendit Publik. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik është strukturë e veçantë e pavarur policore në zbatimin e ligjit, në varësi të Ministrit të Rendit Publik. Ky shërbim ka të drejtë të mbledhë, të administrojë, të ruajë dhe të verifikojë të dhënat për veprimtaritë kriminale, kur ato kryhen nga punonjësi i Policisë së Shtetit i Ministrisë së Rendit Publik, pavarësisht nga detyra dhe grada. Ky lloj shërbimi përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e dokumentacionit dhe të të dhënave. Përveç kësaj dokumentacionet e Shërbimit Informativ të Rendit (SHIR) i kalojnë në dispozicion Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm. Me miratimin e këtij ligji shfuqizohet ligji nr.7530, datë 11.12.1991 “Për shërbimin e kundërzbulimit në organet e Rendit Publik”, ndryshuar me ligjin nr.7882, datë 1.12.1994. Ligji ka 17 nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15 të vitit 2001, faqe 413.

Ligji nr.8750, datë 26.3.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope”. Ky ligj përcakton normat për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope, si dhe të përdorimit të paligjshëm të substancave kimike bazë e të prekursorëve, që përdoren për prodhimin e substancave të sipërpërmendura. Gjithashtu, po me këtë ligj krijohet Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Luftës kundër Drogës, nën drejtimin e Kryeministrit. Në përbërje të këtij Komiteti janë ministrat e shumicës së ministrive dhe, për realizimin e veprimtarisë së tij, ky Komitet ka një sekretari, drejtuesi i së cilës emërohet nga Kryeministri. Ligji krijon pranë Këshillit të Ministrave edhe Zyrën e Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën, e cila është në

varësi të drejtuesit të Sekretarisë së Komitetit Ndërministror të Bashkërendimit. Shërbimi i luftës kundër drogës, si dhe procedurat dhe mënyra e asgjësimit të substancave, trajtohen, gjithashtu, në disa nga nenet e këtij ligji. Ligji ka 32 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.4.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.14 të vitit 2001, faqe 391. Ligjit i bashkëlidhet edhe tabela e prekursorëve.

Ligji nr.8751, datë 26.3.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8292, datë 25.2.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”. Sipas këtij ligji, Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë janë struktura të Policisë së Shtetit, të krijuara për të realizuar misione ndërhyrjeje dhe sigurimi, ekzekutimi i të cilave kërkon personel të përgatitur dhe të pajisur në mënyrë të posaçme. Përveç këtij saktësimi, shtesat dhe ndryshimet në ligjin ekzistues kanë të bëjnë me garancitë që u jepen këtyre forcave, me detyrat funksionale, duke i ndarë këto veçmas për Forcat Speciale dhe veçmas për Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë. Rregullim më të plotë gjen edhe pranimi në këto forca, duke marrë për bazë kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Ligji ka 12 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.4.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.14 të vitit 2001, faqe 398.

Ligji nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”. Ligji ka për qëllim të përcaktojë strukturat pranë organeve të qeverisjes vendore për ruajtjen dhe administrimin e tokës dhe krijon pranë Këshillit të Qarkut Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës si funksion i deleguar i Këshillit të Ministrave. Këto seksione dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në bashki dhe/ose komunë kanë varësi teknike nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Objekti dhe funksionet e Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark rregullohen në mënyrë të hollësishme në

kreun III të ligjit. Po në këtë kre janë edhe sanksionet për mosmarrjen e masave mbrojtëse dhe moszbatimin e tyre për dëmtimet fizike, për dëmtimet e pjellorisë nga erozioni, ndotja dhe degradimi. Ligji ka 19 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.4.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.14 të vitit 2001, faqe 400.

Ligji nr.8753, datë 26.3.2001 “Për një shtesë në ligjin nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8361, datë 1.7.1998, nr.8421, datë 28.10.1998 dhe nr.8452, datë 28.1.1999”. Neni 2 i ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 ka në mënyrë të shprehur se cilët personalitete merr në ruajtje Garda e Republikës. Në shkronjën “b” të nenit 2, në listën e personaliteteve që merr në ruajtje Garda e Republikës, shtohet edhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.4.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.14 të vitit 2001, faqe 404.

Ligji nr.8754, datë 26.3.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave”. Konventa ndërkombëtare për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave ka si qëllim të përmirësojë lëvizjen ndërkombëtare të mallrave me anën e lehtësimit të kalimit të tyre në kufi, duke pasur parasysh që kushtet në të cilat kryhen këto kontrole mund të harmonizohen pa dëmtuar qëllimin në vetvete të kontrollit dhe të efektivitetit të tij. Konventa bën harmonizimin e procedurave, vendos rregulla lidhur me tranzitimin e mallrave, harmonizimin e kontrollit doganor dhe të kontroleve të tjera, rregullon kontrollin mjeko-veterinar e kontrollin veterinar, kontrollin fitosanitar, kontrollin e përputhshmërisë me standardet teknike, kontrollin e cilësisë etj. Aderimi në këtë Konventë është bërë me ligjin nr.8754, datë 26.3.2001, i cili ka dy nene, ka hyrë në fuqi më 1.5.2001 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.15 të vitit 2001, faqe 415. Ligjit i bashkëlidhet Konventa.

Ligji nr.8755, datë 26.3.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian për Programet e Ndhmës Humanitare””. Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian mbi Programet e Ndhmës Humanitare është bërë që të realizojë bashkëpunimin midis palëve kontraktuese, me qëllim që të zbatojë veprime të ndihmës humanitare, siç është cilësuar në Rregulloren e Këshillit të Komunitetit Europian nr.1257/96 të 20 qershorit 1996. Çdo veprimtari brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në përputhje me kushtet e vendosura në Aneksin 1, që rregullon probleme të tilla si vendosjen, akomodimin, hyrjen dhe lehtësitë e qëndrimit të personelit, që zbaton veprimtaritë e financuara nga Komuniteti, importin dhe rieksporin e pajisjeve, taksat dhe doganat etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15 të vitit 2001, faqe 432. Bashkë me ligjin janë botuar edhe Marrëveshja dhe Aneksi 1.

Ligji nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”. Me këtë ligj sanksionohet që planifikimi dhe përballimi i emergjencave civile janë detyra të shtetit shqiptar që synon në parandalimin, pakësimin dhe ratifikimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile. Gjithashtu, synohet sigurimi i kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës, në një situatë emergjente. Ligji përcakton edhe strukturat e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qendror dhe në nivel qarku, bashkie dhe komune, saktëson forcat e ndërhyrjes, si dhe subjektet që përfshihen në planizimin dhe përballimin e emergjencave civile. Në Kreun VI flitet për burimet financiare për përballimin e emergjencave civile dhe në Kreun VIII janë sanksionet për mosrespektimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet dekreti

nr.3824, datë 1.12.1964 i Presidiumit të Kuvendit Popullor “Për mbrojtjen civile të Republikës”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj. Ligji ka 37 nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.5.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.15 të vitit 2001, faqe 435.

Ligji nr.8757, datë 26.3.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve””. Me ligjin e lartpërmendur bëhen shtesa e ndryshime që kanë të bëjnë kryesisht me detyrat e funksionet e Policisë së Burgjeve, me strukturën dhe organizimin e me emërimet dhe gradimet. Kështu në nenin 1 përcaktohet se Policia e Burgjeve gëzon të gjitha të drejtat që parashikon ligji nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe jo më siç ka qenë në nenin 1 të ligjit ekzistues, kur për këto të drejta referimi bëhej në ligjin nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”. Rregullime bëhen edhe në emërimet e funksioneve (neni 5), si dhe në gradimet (neni 11) duke i njësuar ato me të Policisë së Shtetit. Përsa i përket disiplinës dhe procedimit disiplinor, me ndryshimet që bëhen dhe me shteast (nenet 18/1, 18/2 dhe 18/3) përcaktohen shumë më qartë se në ligjin ekzistues se si bëhet procedimi disiplinor, si mund të bëhet ankimi dhe ku bëhet dhe kur shuhet os hiqet masa disiplinore.Ligji ka 16 nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15 të vitit 2001, faqe 446.

Ligji nr.8758, datë 26.3.2001 “Për një ndryshim në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim””. Ky ligj bën vetëm një ndryshim në ligjin që është në fuqi dhe konkretisht ndryshimi bëhet në nenin 22. Në ligjin ekzistues, ky nen përcakton se Policia e Burgjeve është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Me ndryshimin që i bëhet këtij neni, përcaktohet se Policia e Burgjeve është strukturë e armatosur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe veprimtaria e kësaj policie rregullohet nga ligji nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve”.Ligji

ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15 të vitit 2001, faqe 450.

Ligji nr.8759, datë 26.3.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën ndërkombëtare për asistencë të ndërsjellë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore””. Konventa ndërkombëtare për asistencën e ndërsjellë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore (Nairobi, 9 qershor 1977), si dhe shumë Aneksë të saj, krijon mundësinë e kërkimit të asistencës të ndërsjellë gjatë çdo lloj investigimi ose në lidhje me ndjekjet penale ose administrative që ndërmerren nga një palë kontraktuese, për të parandaluar, hetuar dhe goditur shkeljet doganore. Konventa u lë mundësi palëve kontraktuese që në rast se një prej tyre e konsideron se asistencë e kërkuar bie në kundërshtim me sovranitetin, sigurinë ose interesa të tjerë themelorë kombëtarë ose dëmton interesat legjitime komerciale të ndonjë kompanie, publike ose private, ajo mund të mohojë dhënien e kësaj asistencë ose të japë sipas disa kushteve ose kërkesave të përcaktuara. Ligji që ka miratuar aderimin në këtë Konventë ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15 të vitit 2001, faqe 450. Bashkëlidhet Konventa dhe Ankesat.

Ligji nr.8760, datë 26.3.2001 “Për pagesat me këste të taksave nga operatorët privatë radio dhe televizivë gjatë periudhës tranzitore të vitit 2001”. Sipas këtij ligji, edhe kur personi i interesuar nuk ka respektuar pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, që thotë se licenca bëhet e pavlefshme kur kërkuesi nuk e tërheq atë ose nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj, pas 90 ditëve nga çasti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj, pra, edhe kur nuk respekton këto kërkesa, veprimtaria e subjekteve radiotelevizive të licencuara nuk konsiderohet se

është në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse, në qoftë se këto subjekte paguajnë taksat dhe tarifat e tjera në përputhje me këtë ligj. Gjithashtu, ligji i lartpërmendur bën përjashtim për vitin 2000 e 2001, duke lejuar që detyrimet nga taksat të paguhen me këste tremujore brenda datës 31.12.2001. Ky ligj është propozuar nga një grup deputetësh, ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15 të vitit 2001, faqe 470.

Ligji nr.8761, datë 2.4.2001 “Për miratimin e “Marrëveshjes së Konkensionit të formës “BOT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë së të drejtës turke “BER-ONER” për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të kromit, si dhe për dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për konkensionarin e kësaj marrëveshjeje”. Ky ligj miraton Marrëveshjen e Konkensionit, Marrëveshje e cila ka për objekt dhënien në konkension të objekteve që OSHA (Organi Shtetëror i Autorizuar nga Këshilli i Ministrave) ia beson KonkensionErit, për të realizuar rehabilitimin, modernizimin, financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e këtij objekti. Lista e objekteve të industrisë së bakrit dhe të kromit që jepen në konkension është përcaktuar në Aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij ligji. Marrëveshja përcakton kriteret specifike të punimeve, kohën e fillimit të tyre, detyrimet e të rejtat e konkensionErit, detyrimet e Organit Shtetëror të Autorizuar, vlerësimin e investimit, periudhën e konkensionit, legjislacionin e zbatueshëm, hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj. Ligji ka 6 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.18 të vitit 2001 faqe 537. Bashkëlidhet Marrëveshja dhe 3 Aneksë.

Ligji nr.8762, datë 2.4.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së hipotekimit për ndërtimin e Hidrocentralit të Bushatit”. Kjo Marrëveshje hipotekimi që është ratifikuar me ligjin e lartpërmendur është

lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Bakës Kineze Eksport-Import (“EXIM Bank”) për ndëritmin e Hydrocentralit të Bushatit. Banka e lartpërmendur do të japë një kredi lehtësuese deri në shumën 119.728.000 USD, dhe si garanci për rimbursimin e plotë në favor të “EXIM Bank” të të gjitha shumave në zbatim të Marrëveshjes së Kredisë, hipotekuesi ka rënë dakord të sigurojë garanci në favor të “EXIM Bank” sipas Kontratës së Hipotekimit. Marrëveshja e Hipotekimit do të udhëhiqet nga ligji shqiptar.

Ligji nr.8762, datë 2.4.2001 ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.19 të vitit 2001, faqe 563. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja e Hipotekimit.

Një këndvështrim në zhvillimet e fundit drejt marrëveshjes së asociim-stabilizimit

Detyrat apo punët e shtëpisë?

Nga Leon Shestani

Pas 24 janarit të këtij viti, intensiteti i ngjarjeve në Shqipëri ka qenë veçanërisht i lartë, përfshi këtu edhe ngjarjet e orëve të para të kësaj date. Natyrisht, kur ndodhin shumë gjëra, ndonjëherë edhe pak të lidhura me njëra-tjetrën, është pothuaj e sigurt që efekti i tyre nuk mund të jetë gjithnjë në të njëjtin kah.

Asociim-stabilizimi është fjala më e lakuar, me të cilën edhe spekulohet më shumë në këtë periudhë. Integrimi po ashtu. Ndokush thotë, pse, kriza morale, nuk është e rëndësishme?

Pavarësisht nga ato që shkruhen dhe komentohen gjatë lidhur me pas-takimin e Brukselit, vlen të kujtohet që natyra e ndodhive të fundit po e eklipson edhe debatin për ata që kualifikohen si pengesat drejt arritjes së marrëveshjes së asociim-stabilizimit për Shqipërinë.

Ky eklipsim nuk duhet të kuptohet vetëm si “tërheqje e vëmendjes nga reformat kryesore” ose “largim nga këto reforma”, dhe as si mungesë në debatet publike. Kjo, në radhë të parë, e mbi të gjitha, është e prekshme në varfërinë e debatit politik për rrugët që duhen ndjekur drejt përbushjes së prerekuizitave të duhura, për të ndryshuar kahun dhe përcaktuar prirje të reja zhvillimi të angazhimeve të marra.

Nuk ka dyshim që çështja e asociim-stabilizimit përkthehet/shprehet në radhë të parë me prirjet e reformave dhe aspektin programatiko-zbatues. Por, nuk duhet të ketë, gjithashtu, dyshim që marrëveshja në fjalë nuk është e lidhur *sin e qua non* me plotësimin e kushteve të radhitura në raportin e Komisionit të Jashtëm.

Klima dhe fryma e zhvillimeve në këto fusha është më e rëndësishme. Këto reforma nuk janë çështje të një mandati qeverisës, këto e kapërcejnë në kohë dhe objektiva një të tillë, si dhe programin më ambicioz të një force të vetme politike. Ilustrim ezaurues për këtë është reforma në gjyqësor.

Po le të kthehemi në kushtet/pengesat/sfidat me të cilat do të përballemi në të ardhmen jo vetëm të afërt, mbështetur gjithnjë sipas raportit që pritet t'i adresohet Parlamentit Europian nga Komisioni për Politikën e Jashtme.

Vërehet se pengesat janë:

- Vështirësitë që lidhen me funksionimin e sistemit të drejtësisë: funksionimi i sistemit gjyqësor është gjithnjë me probleme (në burime njerëzore dhe materiale); gjyqtarët janë të paafhtë për të zbatuar legjislacionin në fuqi. Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë dhe korrupsioni në të janë po ashtu në evidencë të lartë. Gjithashtu, një element i rëndësishëm është niveli i ulët i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

- Korrupsioni masiv: Pavarësisht nga krijimi i shumë strukturave represive, ende nuk ekzistojnë mjetet për të zbatuar ndryshimet e bëra. Numri i personave të angazhuar në luftën kundër kriminalitetit dhe korrupsionit është i pamjaftueshëm. Strukturat e krijuara rishtas për të luftuar korrupsionin ende nuk janë operative.

- Krimi i organizuar: Sipas komisionit, Shqipëria është në të njëjtën kohë burim dhe një qendër tranziti përsa i përket trafikut të qënieve njerëzore, në veçanti të femrave. Asnjë akord nuk mund të parashihet i mundshëm, nëse Shqipëria nuk provon vendosmërinë e saj dhe angazhimin e vërtetë për të përballuar këto probleme. Sipas raportit të Komisionit, emigracioni ilegal, si dhe trafiku i drogës dhe armëve janë, gjithashtu, dy çështje shumë serioze,

që duhen shqyrtuar me kujdes të veçantë. Transformimi i administrimit dhe kontrollet më të frytshme të kufijve shtetërorë duhet konsideruar, gjithashtu, si një aspekt parësor.

- Sektori ekonomik: Pavarësisht nga progreset e shënuara në stabilizimin e ekonomisë, dobësitë strukturore janë të rëndësishme dhe substanciale. Masa e ekonomisë paralele kërcënon qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve ekonomike të deklaruara zyrtarisht dhe u bën atyre një konkurrencë të pandershme, gjë që dekurajon investimet. Komisioni këmbëngul, po ashtu, në nevojën për mbështetjen urgjente në infrastrukturë dhe energji.

- Shkalla e ulët e zbatueshmërisë së ligjit (mungesa e aftësive administrative): theksohet shkalla e lartë e paaftësisë dhe varësia e administratës publike nga politika. Kjo e shoqëruar me mungesa të theksuara dhe paaftësi të saj për të zbatuar legjislationin në fuqi, si dhe reformat legjislative të duhura për arritjen e marrëveshjes së asociim-stabilizimit. Kapaciteti për krijimin e një kuadri juridik të caktuar nuk është shoqëruar ende me arritjen e kapaciteteve zbatuese.

Këshilli, në mbledhjen e 10 dhjetorit 2001, kishte paraparë mundësinë e hapjes së negociatave në semestrin e parë të 2001-it. Mbledhja e radhës e këtij organi, minimalisht mund të thuhet që nuk shënoi një hap përpara në këtë proces për Shqipërinë. Duke e parë “gjysmën e shishes plot” mund të thuhet se jemi në “stand-by”, por me një sistem “back-up” shumë të brishtë, për shumë arsye, por mbi të gjitha, ndoshta si rezultat i një situatë politike konfliktuale të paprecedentë në Shqipëri.

Shumë energji harxhohet në debate të rëndësishme, por jo në hartimin e planeve të veprimit dhe strategjive për çështjet që janë themelore në këtë proces integrimi. Reforma kushtetuese, zgjedhore, zgjedhja e presidentit janë çështje të rëndësishme, vërtet të dorës së parë. Por, për të përmendur disa, a nuk janë po aq të rëndësishme çështje të tilla, si reforma në sistemin e drejtësisë, lufta kundër trafikut të qënieve njerëzore apo krimin të organizuar?

Jemi dëshmitarë të hartimit së fundi nga Qeveria të një platforme antikorrupsion. Po askush nuk pyet për planin e veprimit të kësaj platforme, faturën ekonomike dhe afatet kohore për zbatueshmërinë e saj. Pse ndodh kështu? A mos ishte e rëndësishme që vetëm të kemi në letër një platformë të tillë, të përshëndetur edhe nga opozita (për hir të së vërtetës, pothuaj e njëjtë me atë të shpallur me kohë nga opozita kryesore)? Ka ardhur koha që të organizohemi dhe të jemi konsistentë në angazhimet tona, në radhë të parë përballë publikut të gjerë.

Në konceptin tim nuk do të ishte më mirë, pse jo më e shëndetshme, që kur flasim për “detyrat e shtëpisë” të kemi parasysh “punët e shtëpisë”? Megjithëse diferenca mund të duket e vogël, në këtë terminologji, shqipja ia kalon dhe anglishtes! *Home work* është më shumë detyrat që t'i kanë dhënë të tjerët, ndërsa në shqipen tonë të dashur, “punët e shtëpisë” do të donin të thonin në radhë të parë pastrimi i saj, p.sh. nga korrupsioni, krimi i organizuar dhe trafiqet, shëndoshja e gjyqësorit, reforma administrative e kështu me radhë. Këto nuk janë detyra që duhet të na i lënë të tjerët, si p.sh. përshtatja/harmonizimi i legjislacioni tonë me atë komunitar ose ratifikimi i konventave të caktuara. Nuk e di nëse do ta ndihmojmë veten në këto ndërmarrje të vështira, duke i konsideruar si detyra të lëna nga të tjerët apo duke i trajtuar si nevoja thelbësore, pa përballimin e të cilave shtëpia vështirë se mund të “ekspozohet”/integrohet.

Normalisht, koha që i duhet Këshillit për dhënien e mandatit Komisionit për negocimin e një marrëveshjeje asociim-stabilizimi është minimalisht tre ose katër muaj. Mund të parashikohet që hapja e negociatave do të mund të ndodhë në fund të muajit maj ose në qershor 2002. Megjithatë, duke marrë parasysh se rezervat e paraqitura nga Franca, Britania e Madhe dhe Suedia, lidhur me nismën e shpejtimit të procesit të afrimit të Shqipërisë në procesin e asociim-stabilizimit mund të përfshijnë edhe vende të tjera, për arsye të parregullsive që lidhen me problemet zgjedhore, si dhe problemet e krijuara në partinë në pushtet.

Information on laws passed by Assembly

Law no.8748 dated 1 March 2001 “ On ratification of the “Agreement between the Republic of Albania and the Pan Hellenic Exports Association for the consolidation of the External debt of Albania.”” Under this law the agreement concerning the consolidation of the debts for the unpaid sum of the invoices and the interests over these sums stemming from the trade transactions not completed before 31 December 1991 remained unpaid up to 20 October 2000 is ratified. The agreement contains in detail the name of the Creditor Company, the sum of the unpaid invoice and the interest. The law has 2 articles and entered into force on 7 March 2001. It is published in the Official Gazette no. 9, 2001, p. 176.

Law no.8749, dated 1 March 2001 “ On the internal control service in the Ministry of Public Order”. According to the above mentioned law the object of work of this service is the prevention, discovery and documentation of the criminal activity carried out by the servants of the State Police and the other structures in the Ministry of the Public Order. The internal control service in the Ministry of Public Order is a special independent police structure in the implementation of law, subject to the Minister of the Public Order. This service has the right to collect, administer, save and verify the data on the criminal activity, in cases when this activity is performed by the servant of the State Police of the Ministry of Public Order, irrespective of position or rank. This kind of service is excluded from the obligations that require the publication of the documentation and the data. Moreover, the documentation of the

Informative Service of the Order (SHIR) is left at the disposal of the Internal Control Service. With the approval of this law, law no. 7530, dated 11 December 1991 “On the Counterintelligence Service in the Institutions of the Public Order”, amended in law no. 7882, dated 1 December 1994. The law has 17 articles and entered into force on 1 May 2001. It is published in the Official Gazette no. 15, 2001,p.413.

Law no.8750, dated 26 March 2001 “On the prevention and fight against the traffic of the narcotic and psychotrop substances”. This law defines the norms for the prevention and the fight against the traffic of the narcotic and psychotrop substances, as well as the illegal use of the chemical substances serving as the basis of the precursors, employed in the production of the above mentioned substances. Besides, through this law the National Committee of the co-ordination of the fight against drugs is established, headed by the Prime Minister. This Committee is made up of ministers from most Ministries and for the accomplishment of its activity, the committee has a secretary, the head of which is appointed by the Prime Minister. Under this law the office of the National System of the Data on Drugs is set up in the Council of Ministers, subject to the head of the Secretary of the Inter Ministry Co-ordination Committee. The fight against drugs, as well as the procedures and the extermination methods of the substances are dealt with in some articles of this law. The law has 32 articles and entered into force on 28 April 2001. It is published in the Official Gazette no.14, 2001,p.391. The table of the precursors is attached to the law.

Law no. 8751,dated 26 March 2001 “On some supplements and amendments to law no.8292, dated 25 February 1998 “On the Special Forces and Swots. Pursuant to this law Special Forces and Swots are structures of the State Police, built to execute intervention and security missions, whose execution requires a well-trained and properly equipped staff. In addition to this

correction, the supplements and the amendments to the existing law deal with the guarantees these forces are given, and their functional duties separately divided for the Special Forces and Swots. The admission to these forces is regulated based on the criteria provided by law no. 8553, dated 25 November 1999 “ On the State Police”. The law has 12 articles and entered into force on 28 April 2001. It is published in the Official Gazette no.14, 2001, p.398.

Law no. 8752, dated 26 March 2001 “ On the establishment and functioning of the structures for the administration and protection of land”. This law aims at laying down the structures in the local government bodies for the protection and the administration of land and creates the section of the Administration and the Protection of Land in the Council of the Circle, as a delegated function of the Council of Ministers. These sections as well as the offices of Management and protection of land in the Municipality and/or communes are technically subjected to the Ministry of Agriculture and Food. Chapter III of the law regulates in detail the object and the functions of the Sections of Administration and the Protection of land in the circle. In Chapter III you will also find the sanctions for not taking precautions and their non-application concerning the physical damage, fertility damage caused by erosion, pollution and degradation. The law has 19 articles and entered into force on 28 April 2001. It is published in the Official Gazette no.14, 2001,p. 400.

Law no. 8753 dated 26 March 2001 “ For a supplement to the law no. 7602, dated 9 October 1992 “ On the Guard of the Republic of Albania” amended by law no. 8361, dated 1 July 1998; no. 8421, dated 28 October 1998; and no.28 January 1999. Article 2 of law no. 7602, dated 9 October 1992 has explicitly expressed who are the personalities the Guard of the Republic has under protection. The Mayor is added to the list of the personalities that are under the protection of the Guard of the Republic provided by letter b of article 2. The law has 2 articles and entered into force on 28 April 2001. It is published in the Official Gazette no. 14,2001p. 404.21 81605.

Law no. 8754, dated 26 March 2001 “ On the adherence of the Republic of Albania to the “ Convention for the accord of border control rules of the goods””. The international convention for the accord of border control rules of the goods aims at improving the international movement of the goods by means of facilitating their transition at the check points, considering the condition under which these controls are made they can be harmonised without impairing the purpose and the efficiency of the control itself. The convention realises the harmonisation of the procedures, sets rules concerning the transition of the goods, harmonisation of the customs control and other controls, regulates the medical veterinary and the veterinary control, **phytosanitary** control, the check up of the compatibility with the technical standards, quality control etc. The adherence to this Convention is realised by law no. 8754 dated 26 March 2001. The law has two articles and entered into force on 1 May 2001, It is published in the Official Gazette no. 15, 2001, p.415. The Convention is attached to the law.

Law no. 8755, dated 26 March 2001 “ On the ratification of the “ Agreement between the Government of the Republic of Albania and the Commission of the European Community concerning the Programs of the Humanitarian Aid””. The Agreement between the Republic of Albania and the Commission of the European Community concerning the Programs of the Humanitarian Aid aims at realising the co-operation between contractual parties, in order to apply the acts of the humanitarian aid, as it is defined in the Regulation of the Council of the European Community no. 1257/96, 26 June 1996. Every activity, in the framework of this agreement, will be carried out in conformity with the conditions set in Annex 1, which regulate problems such as location, accommodation, entrance and accommodation facilities for staff that implements the activities financed by the Community, imports and re-exports of the equipment, taxes and customs duties etc. The law has two articles and entered into force on 1 May 2001. It is published in the Official Ga-

zette no. 15, 2001.p. 432. The Agreement and Annex 1 have been published attached to the law.

The law no. 8756, dated 26 March 2001 “ On the civil emergencies”.

This law sanctions that the planning and the facing of the civil emergencies are the obligations of the Albanian State that aim at the prevention, reduction and the ratification from any damage caused to the population, livestock, property, cultural heritage, environment and the civil emergencies. Besides, this aims to insure appropriate conditions for the state, public and private institutions, for the economic activities and the population, during the transition from a normal state of living and working to an emergent one. The law lays down the structures of planning and the confrontation with the civil emergencies at a central, circle, municipality and community level, determines with precision the Intervention Forces, as well as the subjects that are included in the planning and the confrontation with the civil emergencies. Chapter IV stipulates the financial sources for the facing of the civil emergencies, whereas Chapter V the sanctions for the non-observance of the obligations set in this law. With the entering into force of this law the decree no. 3824, dated 1 December 1964 of the Presidium of the People’s Assembly “On the civil protection of the Republic” is repealed, as well as other provisions that contradict this law. This law has 37 articles and entered into force on 1 May 2001. It is published in the Official Gazette no. 15, 2001, p.435.

Law no. 8757 dated 26 March 2001 “ On the supplements and amendments to the law no. 8321 dated 1 April 1998 “ On the State Police”. The above-mentioned law makes some supplements and amendments to the duties and functions of the Prison Police, as to the structure, organisation, appointments and promotion in rank. Therefore, article 1 lays down all the rights the Prison Police enjoys provided by law no. 8553 dated 25 November 1999 “ On the State Police” not as it used to be provided in article 1 of the existing law,

when, for all these rights they referred to law no. 7496 dated 3 July 1991 “ On the status of the military officer of the Armed Forces in the Republic of Albania”. This law, unifying them with the State Police regulates the appointments of the functions (article 5) as well as the promotions in ranks (article 11). As to the discipline and the disciplinary proceedings, with the amendments and supplements to the (articles 18/1,18/2,and 18/3) concerning how the disciplinary proceedings should be performed, how to deposit a complaint, where and when the disciplinary measure can be withdrawn or lifted, are better defined than in the previous law. The law has 16 articles and entered into force on 1 May 2001. It is published in the Official Gazette no. 15, 2001,p.446.

Law no. 8758 dated 26 March 2001 “ On an amendment to law no. 8328 dated 16 April 1998 “ On the rights and the treatment of the prisoners”. This law makes only one amendment to the law that is into force and precisely to the article 22. The article in existing law envisions that the Prison Police is subject to the Minister of Justice. With the amendment to this article, the Prison Police is an armed structure in the General Directory of the Prisons and the activity of this directory is regulated by law no.8321, dated 2 April 1998 “ On the Prison Police”. The law has 2 articles and entered into force on 1 May 2001. It is published in the Official Gazette no. 15, 2001, p.450.

Law no.8759, dated 26 March 2001 “ On the Adherence of the Republic of Albania to “ The International Convention for mutual administrative assistance regarding the prevention, investigation and the attack to the customs violations”. The International Convention for mutual administrative assistance regarding the prevention, investigation and the attack to the customs violations (Nairobi, 9 June 1977), as well as many of its Annexes, provide the opportunity to ask for mutual administrative assistance in the process of any kind of investigations, the criminal or administrative prosecutions that are undertaken by any contractual parties to prevent, investigate as well as attack the customs violations. The Convention gives the possibility to the con-

tractual parties, if any of them considers that the required assistance is in objection to the sovereignty, security or other fundamental national interests or affects the legitimate commercial interests of any private or public companies, they can deny the giving of this assistance or can do so on some prior conditions and requirements. The Law has two articles and entered into force on 1 May 2001. It is published in the Official Gazette no. 15, 2001, p. 450. The Convention and the Annexes have been attached to this law.

Law no. 8760 dated 26 March 2001 “ On the payment by instalments of the taxes from the private radio and television operators, during the transitory period of 2001.” According to this law, even in those cases when the interested person has not observed point 5 article 33 law no. 8410 dated 30 September 1998 “On the public and private radio and television in the Republic of Albania”, which states that the license becomes invalid when the applicant does not withdraw it or does not observe the obligations provided by law, 90 days since the moment when it is officially informed about its approval, that is even when these requirements are not observed, the activity of the licensed radio and television subjects is not considered to be in objection to the relevant legal provisions, if these subjects pay the taxes and other duties in conformity with this law. Besides, in the above-mentioned law the years 2000 and 2001 make an exception, allowing the duties from the taxes to be paid by three-month instalments by 31 December 2001. This law has been initiated by a group of MP-s. It has two articles and entered into force on 1 May 2001. It is published in the Official Gazette no.15, 2001, p.470.

Law no. 8761 dated 2 April 2001” On the Approval of the Concession Form “BOT” between the Ministry of the Public Economy and Privatisation and the Association of the Turkish right “BER-ONER” for some objects of the copper and chrome industry, as well as for the issuing of some stimuli and guarantee concerning the concessionaire of this agreement.”

This law ratifies the Agreement of the Concession, which has as its object the issuing in concession of the objects that the Authorised State Body by the Council of Ministers entrusts to the concessionaire in order to perform the rehabilitation, modernisation, financing, administration and the exploitation of this object. The list of the objects of the copper and chrome industry that are given in concession are provided in Annex 1 attached to this law. The agreement lays down the specific criteria of the works, the beginning, duties and the rights of the concessionaire, the duties of the Authorised State Body, evaluation of the investment, period of the concession, applicable legislation, entering into force of the Agreement, solution of the disagreements etc. The law has 6 articles and entered into force on 15 may 2001. It is published in the Official Gazette no. 18,2001,p.537. The Agreement and 3 Annexes are attached to it.

Law no. 8762 dated 2 April 2001 “ On the ratification of “ The Mortgaging Agreement for the building of the water-power station of Bushati”. This mortgaging agreement that is ratified by the above-mentioned law is made between the Ministry of the Public Economy and Privatisation and the Export Import Chinese Bank (EXIM Bank) for the building of the water- power station of Bushati. The above-mentioned bank will give an attenuating credit up to 119.728.000 USD and as a guarantee for the complete reimbursement in favour of the “ EXIM Bank” of all the totals during the implementation of the Credit Agreement, the mortgager has agreed to provide guarantee in favour of the “ EXIM Bank” pursuant to the Mortgaging Contract. The Mortgaging Agreement shall be abided by the Albanian law.

Law no. 8762 dated 2 April 2001 has two Articles and entered into force on 19 May 2001. It is published in the Official Gazette no. 19, 2001, p.563. The Mortgaging Agreement is attached to this law.

Personat që janë të interesuar të
abonohen në këtë Revistë, janë të lutur
të kontaktojnë në adresën:

Rruga “Vaso Pasha”, Pall.2, shk. 1.

☎: 04 223501, e-mail:

berberiscdp@albaniaonline.net

Botuesit e kësaj Reviste mirëpresin dhe e
vlerësojnë si ndihmë çdo vërejtje apo sugjerim për
përmirësimin e cilësisë së Revistës. Vërejtjet dhe
sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni në adresën e
sipërpërmendur.

Ju faleminderit!

*Those who are interested to register are
pleased to contact at:*

Rruga “Vaso Pasha”, Pall.2, shk. 1.

☎: 04 223501, e-mail:

berberiscdp@albaniaonline.net

The editors welcome any suggestion or comment
to improve the quality of the Review. You can send
your comments and suggestions to the above
mentioned address.

Thank You!

Kopertina: R&T Advertising

Art grafik: Elvira Çiraku

Shtypur në shtypshkronjën “ALB Paper”

Drejtor i Revistës: Sokol BERBERI

Kryeredaktore: Elira ZAKA

Bordi editorial: Filip LAKO
Perikli ZAHARIA
Leon SHESTANI
Sokol BERBERI

Përkthyes: Engjëllushe SHQARRI

Redaktor: Pandeli KOÇI

©Copyright 2001: Qendra Studimore mbi Praktikrat
Parlamentare dhe Demokratike

**Kjo revistë botohet me mbështetjen financiare të
International Republican Institute (IRI)
dhe National Endowment for Democracy (NED)**

